

ENTI RREGULLATOR I UJIT



RAPORT

BILANCI I UJIT I SHOQËRIVE UK

VITI 2024

Tiranë, 2025

PËRMBAJTJA

1. Të Përgjithshme	5
2. Metodologjia e Hartimit të Bilancit të Ujit.	8
2.1 Bilanci i Ujit, Komponentët Përbërës të Tij	10
2.2 Analiza e Ujit Pa të Ardhura (UPA) për Shoqëritë Rajonale në shkallë vendi.....	10
3. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Berat.....	13
4. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Dibër.....	17
5. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Durrës.....	22
6. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan	26
7. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Fier	31
8. Analiza e “Uji Pa të Ardhura” (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë.....	35
9. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Korçë	39
10. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Kukës	44
11. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë	48
12. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Lushnje	52
13. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Pogradec.....	56
14. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë	61
15. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër	65
16. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Vlorë.....	70
17. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Tiranë	75
18. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Vorë.....	79
19. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Kamëz	83
ANEKSI 1. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	89
ANEKSI 2. Tabela Përmbledhëse e Bilancit të Ujit për çdo Shoqëri	90

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve Kombëtare për vitin 2024	8
Tabela 2. Bilanci i Ujit sipas IWA-s	9
Tabela 3. Bilanci i Ujit në nivel kombëtar për Vitin 2024.....	11
Tabela 4. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	13
Tabela 5. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve.....	14
Tabela 6. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Berat – Viti 2024.....	15
Tabela 7. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	18
Tabela 8. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve.....	18
Tabela 9. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Dibër – Viti 2024	19
Tabela 10. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe.....	22
Tabela 11. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	23
Tabela 12. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Durrës – Viti 2024.....	24
Tabela 13. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	27
Tabela 14. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë dhe Disponibiliteti i Burimeve	27
Tabela 15. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan – Viti 2024	28
Tabela 16. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	31
Tabela 17. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	31
Tabela 18. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Fier – Viti 2024.	32
Tabela 19. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare më Matje dhe Aforfe	35
Tabela 20. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	36
Tabela 21. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë – Viti 2024	37
Tabela 22. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe.	40
Tabela 23. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	40
Tabela 24. Bilancit i Ujit për ish Shoqërinë Rajonale UK Korçë sh.a.- Viti 2024.	41
Tabela 25. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	44
Tabela 26. Konsumi i faturuar për konsumatorët familjare dhe disponibiliteti i burimeve.....	45
Tabela 27. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Kukës – Viti 2024.....	46
Tabela 28. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	49
Tabela 29. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	49
Tabela 30. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë – Viti 2024	50
Tabela 31. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	53
Tabela 32. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	53
Tabela 33. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Lushnjë – Viti 2024	54
Tabela 34. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare më Matje dhe Aforfe	57
Tabela 35. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	57

Tabela 37. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	61
Tabela 38. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	62
Tabela 39. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë – Viti 2024	63
Tabela 40. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfes	66
Tabela 41. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	66
Tabela 42. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër – Viti 2024	67
Tabela 43. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe.....	70
Tabela 44. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	70
Tabela 45. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Vlorë – Viti 2024.....	71
Tabela 46. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe.....	75
Tabela 47. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	75
Tabela 48. Bilancit i Ujit për Shoqërinë UK Tiranë Viti 2024.	77
Tabela 49. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	80
Tabela 50. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	80
Tabela 51. Bilanci i Ujit për Shoqërinë UK Vorë – Viti 2024.....	81
Tabela 52. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	84
Tabela 53. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	84
Tabela 54. Bilanci i Ujit për Shoqërinë UK Kamëz – Viti 2024	86

1. Të Përgjithshme

Bilanci i Ujit është një instrument i rëndësishëm strategjik si dhe një kornizë analitike në matjen e sasisë së ujit që hyn dhe del nga një sistem furnizimi me ujë, duke ndarë qartë sasinë që gjeneron të ardhura dhe atë që humbet ose siç njihet në termin teknik Ujin pa të Ardhura (UPA). UPA është një nga indikatorët kyç për monitorimin e performancës dhe qëndrueshmërisë financiare të shoqërive që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë. Në kushtet e ndryshimeve klimatike, bilanci i ujit është një çështje kritike që paraqet drejtpërdrejt situatën në furnizimin me ujë, cilësinë dhe menaxhimin e burimeve ujore, ndaj dhe ERRU i kushton një vëmendje dhe një nga hapësirat më të rëndësishme të punës së saj, hartimit sa më real dhe të saktë të “Bilancit të Ujit”.

Monitorimi i efikasitetit të ujit dhe sidomos i Ujit pa të Ardhura, pasqyron një qasje të përgjithshme ndaj humbjeve të ujit (përfshirë faktorët teknikë, organizativë dhe ekonomikë). Analiza e sasisë dhe shërndarjes së ujit të disponueshëm për konsum të njeriut është mjaft i rëndësishëm për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt për popullatën, duke shmangur krizën e mundshme të ujit dhe është Bilanci i ujit që e sintetizon më së miri këtë analizë. Referuar këtij koncepti dhe në përmbushje të detyrave të saj ERRU po harton dhe për vitin 2024 Raportin e Bilancit të Ujit për 14 shoqëritë tashmë të rajonalizuara dhe për tre shoqëritë me statusin e mëparshëm.

Menaxhimi i rrjetit të furnizimit me ujë bazuar në konceptin e Zonave me Matje të Pavarura (zonave hidraulike të ndara ku hyrja e ujit monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmes matësve të rrjedhës), që përdoret për të përmirësuar kontrollin, detektimin e humbjeve të ujit dhe efikasitetin operacionale, është i pa aplikuar në shoqëritë tona, ndaj dhe do vazhdohet që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të ujit të përdoret ajo nga “lart-poshtë” (top-down), ku fokusi kryesor në llogaritjen e humbjeve totale është përcaktimi i humbjeve të dukshme (administrative) dhe më tej përcaktohen ato reale (teknike).

Si model i hartimit të Bilancit të Ujit, ERRU me vendimin nr.46, datë 27.12.2013 të Komisionit Kombëtar Rregullator, ka hartuar formatin e “Bilanci i Ujit”, të dhënat e të cilit përpunohen nga sektori teknik dhe licencave i ERRU-së. Ky format bazohet në bilancin e ujit të hartuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Ujit (IWA), i cili është dhe formati më i mirë ndërkombëtar për identifikimin, matjen dhe analizimin e humbjeve të ujit.

Menaxhimi efektiv i ujit të pijshëm nuk mund të kuptohet pa një bilanc të saktë dhe të rregullt të ujit. Ai ndihmon në përmirësimin e performancës së çdo shoqëri rajonale, reduktimin e humbjeve dhe garantimin e shërbimit të qëndrueshëm për qytetarët.

Impakti që ka dhënë reforma në sektorin e ujësjellës kanalizimeve në vitin e saj të dytë do të reflektohet në rezultatet që do të na evidentojë analiza e detajuar për çdo shoqëri rajonale si edhe atyre ekzistuese, lidhur me treguesin e ujit pa të ardhura UPA dhe Bilancit të Ujit. Me anë të analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, të nën komponentëve të saj, do të pasqyrohen arsyet e veçanta të nivelit të lartë të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikat e faturimit me matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme në punën e tyre.

ERRU bazuar në bilancet e dërguara, përgatit raportin vjetor ***“Bilanci i ujit për shoqëritë UK”*** në të cilin aktorët e interesuar njihen me nivelin e UPA në rang sektori dhe të 17 shoqërive UK më vete. Gjithashtu ky raport analizon çështjet që kanë të bëjnë me shërbimin e furnizimit me ujë si prodhimi, faturimi, konsumi i autorizuar i faturuar dhe i pa faturuar, konsumin mesatar ditor, lidhjet e paligjshme, pasaktësitë në matje etj.

Niveli i lartë i Ujit Pa të Ardhura në sektorin UK dhe ritmi i ngadaltë i përmirësimit të tij, ende mbeten shqetësimi më i madh për ERRU-në. Procesi i reduktimit të UPA-së kërkon vëmendjen e duhur dhe të vazhdueshme nga çdo shoqëri ujësjellësi. Përmirësimi organizativ, ndarja e rrjetit me flukse të matura sipas zonave të menaxhimit të presionit (PMA) dhe zonave të matura administrative (DMA), ndihmojnë për të identifikuar, përcaktuar dhe menaxhuar humbjet reale. Rritja e saktësisë në matje për ujin e prodhuar dhe konsumin e matur të klientëve ndihmon për të saktësuar nivelin e UPA dhe shfrytëzimin e burimeve me efikasitet. Është shumë e rëndësishme dhe ndërgjegjësimi publik, raportimi i rrjedhjeve në kohë sjell kursim të ujit dhe reduktim të humbjeve.

Hartimi i planeve 5 vjeçare të biznesit, përfshirja në to i planeve të veprimit për reduktimin e UPA, duhet të jetë pjesë përbërëse e pashmangshme e politikës së menaxhimit të një shoqërie ujësjellësi. Gjatë procesit të hartimit të raportit është konstatuar se pjesa dërmuese e shoqërive UK, paraqesin nevoja për përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve njerëzore që nënkupton së pari transferimin e njohurive, përvojës, aftësive dhe vlerave për të realizuar procesin e reduktimit të UPA sipas planeve të veprimit të përcaktuara.

ERRU thekson se, përkushtimi gjatë hartimit të Bilancit të Ujit, vlerësimi i komponentëve përbërës të tij, bazuar në matje apo vlerësime sa më pranë vlerave reale, është përcaktues në saktësinë e nivelit të Ujit Pa të Ardhura të çdo shoqërie UK. Analiza e bilancit të ujit është thelbësore për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm dhe të efektshëm të burimeve të ujit, duke garantuar që shoqëria të ketë akses në ujë të pastër dhe të sigurt.

Për vitin 2024, u konstatua se “shërbimi i furnizimit me ujë” realizohet për **77.8 %** të popullsisë në juridiksion.

Shoqëritë UK kanë prodhuar **302,816,052m³** ujë, nga të cilat **64.8 %** raportohet i matur dhe **35.2 %** i vlerësuar.

Uji Pa të Ardhura në rang sektori qëndron në nivele të pakënaqshme edhe për këtë vit. Aktualisht, Niveli i **UPA** është **61 %**.

Humbjet Reale përbëjnë **50.2%** të humbjeve të përgjithshme ndërsa Humbjet Administrative **49.7 %** të tyre.

Konsumi i Autorizuar Total rezultoi **118,083,809 m³ ujë**. Konsumi i Autorizuar i Faturuar matet në nivelin **78%** nga 81.24 % që ka rezultuar në vitin 2023. Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar, përbën **0.92 %** të Ujit të prodhuar.

Humbjet nga prezenca e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e transmetimit dhe të shpërndarjes përbëjnë **63.4 %** të humbjeve administrative ndërsa humbjet nga pasaktësia në matje në prodhim dhe në konsumatorë rezultuan **30.2%** e tyre.

Të dhëna të përgjithshme, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, në shkallë vendi jepen në Tabelën 1.

Nga të dhënat e Tabelës 1, referuar raportimeve të shoqërive pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor në shkallë vendi prej 67 l/ditë për banorë, apo konsumit total që rezulton 71.6 l/ditë për banor, është shumë i ulët dhe larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor. Këto vlera tregojnë se shoqëritë duhet të vlerësojnë dhe verifikojnë numrin e banorëve që ju shërbejnë dhe kanë në juridiksionin e tyre, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet që të jenë brenda normës 150 litra/ditë për banor, ose mesatares së sektorit 100 litra/ditë për banor ose të shpjegojë arsyet e këtyre nën faturimeve nga çdo shoqëri dhe a janë reale.

Tabela 1. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve Kombëtare për vitin 2024

Popullsia		Burimet - Kapaciteti i tyre (Kapaciteti shfrytëzues i burimeve ujore për ujë të pijshëm)	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi i ujit të pijshëm për popullsinë			Numri i lidhje të shërbimit		Konsumi i ujit të pijshëm për banorë		
E regjistruar në zonën e shërbimit*	E shërbyer*			Total	I Matur	I pamatur (aforfe)	Me matësa	Pa matësa (aforfe)	I matur	I pamatur (aforfe)	Total (i matur & aforfe)
4,446,331	3,460,045	667,938,852	302,816,052	90,464,000	73,660,000	16,804,000	764,434	114,363	67.0	102.9	71.6

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga tabela 1, shihet se në shkallë vendi ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë të popullatës. Prodhimi i ujit litra/ditë, për banor përgjithësisht është i mjaftueshëm për furnizimin me ujë 24/7 të banorëve.

Në fokusin e shoqërive rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit për të arritur objektivin kombëtar për nivelin e UPA, realizimin e qëllimit final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi, si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

Theksojmë se të dhënat për popullsinë në juridiksion dhe për popullsinë me shërbim, si bazë për llogaritje janë marrë sipas raportimit nga shoqëritë pranë ERRU-së, por vihet re se të dhënat e INSTAT-it për vitin 2024 raportojnë popullsi më të ulët, ndaj duhet insistuar në saktësimin e këtyre të dhënave, të cilat janë bazë në analizën dhe vlerësimin real të disponueshmërisë së burimeve ujore, që shërbejnë për furnizimin e popullatës.

Analiza në vijim nxjerr në pah gjithë problematikat mbi Bilancin e Ujit, UPA dhe nën komponentët përbërës të tij, për çdo shoqëri.

2. Metodologjia e Hartimit të Bilancit të Ujit.

Hartimi i Bilancit të Ujit bëhet duke respektuar formatin e Shoqatës Ndërkombëtare të Ujësjetësve (IWA). Qëllimi kryesor në respektimin e këtij formati është unifikimi i metodologjisë dhe terminologjisë për të gjithë shoqëritë UK duke i vendosur ato në të njëjtat kushte vlerësimi për secilin nga komponentët e bilancit të ujit. Aktualisht për hartimin e bilancit të ujit nga shoqëritë UK përdoret metodika e hartimit të komponentëve nga “lart-poshtë” (top-down) e cila nis nga përllogaritja e Konsumit të Autorizuar të ujit dhe më tej vazhdon me llogaritjen e Humbjeve të

Dukshme ose Humbjeve Administrative. Përcaktimi i Humbjeve Reale ose Fizike sipas kësaj metodologjie kryhet me deduksion.

Në shoqëritë e ujësjellësve të përparuar, me rrjete inxhinierike me matje dhe me teknologjinë e duhur të monitorimit dhe kontrollit të nivelit të humbjeve në çdo pjesë të sistemit, përdoret metoda nga “poshtë lart” (down-top). Zbatimi i vlerësimit nga poshtë lart të humbjeve reale nuk mund të kryhet në rastin e furnizimeve me ujë me ndërprerje, pasi regjimi i furnizimit është i ndërprerë dhe maskohet shumë nga kërkesa gjatë periudhës kohore të kufizuar të furnizimit ndaj nuk mund të zbatohet ende nga asnjë prej shoqërive që operojnë në vendin tonë.

Në tabelën 2, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit të cilat llogariten duke u bazuar në të dhënat e grupuara vjetore nga çdo shoqëri UK.

Tabela 2. Bilanci i Ujit sipas IWA-s

Uji Prodhuar nga Burimet e Veta	Volumi i Ujit që Hyn në Sistem	Konsumi i Autorizuar	Konsumi i Autorizuar, i Faturuar	Uji i eksportuar	Uji me të Ardhura
				Konsum i matur	
				Konsum i pamatur	
Uji Eksportuar (i blerë)		Humbjet e Ujit	Konsum i Autorizuar, i Pa Faturuar	Konsum i matur	Uji Pa të Ardhura
				Konsum i pamatur	
				Konsum i paautorizuar	
			Humbjet Administrative	Pasaktësia në ujëmatëse	
				Gabime sistematike në trajtimin e të dhënave	
				Rrjedhjet në tubacionet e transmetimit dhe shpërndarjes	
			Humbjet Teknike	Rrjedhjet dhe derdhjet në depot e Shoqërive	
				Rrjedhjet në lidhjet e shërbimit të konsumatorëve deri në pikën e matjes	

2.1 Bilanci i Ujit, Komponentët Përbërës të Tij

Volumi i ujit që hyn në sistemin e furnizimit konsiderohet sasia e ujit të prodhuar në një vit kalendarik plus sasinë e ujit të blerë me shumicë nga operatorët e tjerë.

Faktorë përcaktues në nivelin real të treguesit UPA për çdo shoqëri UK mbeten matja në nivele të kënaqshme në prodhim apo përkushtimi gjatë procesit të vlerësimit të volumit të prodhuar në pikat ku ujëmatësit mungojnë. Ende në sektor ekzistojnë operatorë të cilët nuk zbatojnë siç duhet procedurat gjatë vlerësimit të volumeve e për pasojë treguesi UPA ka rezultuar me luhatje të paarsyeshme nga një vit në tjetrin.

ERRU vazhdon të insistojë që shoqëritë UK në mungesë të matësve në burim, kaptazhe, puse, veprat e marrjes nga basenet sipërfaqësorë, si dhe në dalje të stacioneve qendrore të pompimit, të zbatojnë me saktësi dhe përgjegjshmëri procedurat e vlerësimit të volumeve duke u bazuar në rekomandimet teknike.

2.2 Analiza e Ujit Pa të Ardhura (UPA) për Shoqëritë Rajonale në shkallë vendi

Të 14 Shoqëritë Rajonale UK si dhe 3 shoqëritë e pariorganizuara ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë vetëm për 77.8 % të popullsisë totale nga 75.3 % që ishte në vitin 2023. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet **986,526 lidhje për vitin 2024 me një rritje prej 36,253 lidhje krahasuar me vitin 2023**, nga këto **867,649 lidhje** janë të pajisur me aparate ujëmatës ose **87.94 %**.

Prodhimi vjetor 302,816,052 m³ rezulton i matur në nivelin **64.8%** nga **59.86 % në vitin 2023**, ndaj nevoja për aparate ujëmatës në pikat prodhuese është e domosdoshme për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

“Uji Pa të Ardhura” rezultoi në nivelin 61 % të ujit që hyn në sistem, shoqëritë faturojnë vetëm 118,083,809 m³ ujë ose 38.97% të ujit të prodhuar nga 35.33 % që rezultonte në vitin 2023. Tabela 3, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, në nivel kombëtar.

Tabela 3. Bilanci i Ujit në nivel kombëtar për Vitin 2024.

Emërtimi		Njësia	Viti 2024	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	të matur	m ³	196,355,861	64.8%
	të vlerësuar	m ³	106,460,191	35.2%
Volumi total i ujit që futet në sistem		m³	302,816,052	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur		m ³	92,193,195	30.42%
Konsum i ujit të faturuar të matur që shitet tek të tretë		m ³	8,058,425	2.66%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur		m ³	17,832,189	5.88%
Faturimi total		m³	118,083,809	38.97%
Konsumi i Ujit te pa faturuar për sistemet zjarrfikës, pastrim deposh etj.		m ³	2,778,316	
a) sistemi zjarrfikës (nëse dhurohet)		m ³	1,212,040	0.40%
b) Institucionet fetare dhe bamirësie (kisha, xhami, jetimore, azil, etj.) (nëse dhurohet)		m ³	403,655	0.13%
c) Pastrimi i depove dhe i rrugëve		m ³	1,162,621	0.38%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar		m³	2,778,316	0.92%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit		m ³	20,456,200	6.75%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës		m ³	36,976,955	12.20%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	në prodhim	m ³	5,719,256	1.89%
	konsumatorë	m ³	27,301,186	9.01%
Humbjet e dukshme (administrative)		m³	90,453,596	29.85%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit		m ³	14,086,028	4.65%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.		m ³	5,104,181	1.68%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit		m ³	4,361,666	1.44%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes		m ³	49,406,489	16.30%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve ne linjat e sistemit të Ujësjellësit		m ³	18,441,890	6.09%
Humbjet Reale të ujit (teknike)		m³	91,400,254	30.16%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)		m³	181,853,850	60.01%
UJI PA TË ARDHURA		m³	184,632,166	61%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 3:

- Treguesi **UPA** në nivelin **61% nga 64.67%** të prodhimit vjetor, rezulton me përmirësim krahasuar me vitin 2023, por përsëri larg nivelit mesatar për sektorin dhe kërkon angazhime serioze për t'u përmirësuar.
- Niveli i matjes për faktorin **“Uji i Prodhuar”**, është **64.8% nga 59.86 %** që ishte në vitin 2023 dhe tregon për një përmirësim të këtij treguesi.
- **Konsumi total i faturuar** është në nivelin **38.78% nga 35.33 %**, prej të cilit 5.88% është konsum i faturuar i pamatur.

- **Numri i lidhjeve** me ujëmatës është **867,649 klientë dhe përbëjnë 87.9 %** të totalit të klientëve nga **86.5%** që rezultonte për vitin 2023, duke treguar përmirësim të këtij treguesi, i cili reflekton një menaxhim më korrekt të kërkesës për ujë.
- Niveli i humbjeve reale **30.16 %** paraqitet me tendencë uljeje krahasuar me vitin 2023, që ishte në nivelin **31.14%**, dhe vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës që janë në nivelin **16.30%**. Analizimi dhe monitorimi i situatës në terren nga ana e çdo shoqërie është domosdoshmëri për uljen e tyre.
- Niveli i humbjeve të dukshme është **29.85%** e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen, si rezultat i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin **18.95 %** të prodhimit vjetor nga **22.27%** në vitin 2023. ndërsa humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin **10.89%**, mbetet pothuaj i pandryshuar krahasuar me vitin 2023.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërive.
- Stafet e shoqërive në përgjithësi hasin mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.

Rekomandime:

Shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve duhet të jenë të përgatitura që t'i përgjigjen fazës së dytë dhe të tretë të reformës në sektor dhe për këtë duhet:

- *Të vendosin objektiva të matshëm për uljen e humbjeve të ujit brenda planeve të tyre të biznesit.*
- *Të ngrejné dhe të forcojnë njësi të posaçme të menaxhimit të humbjeve brenda strukturave të tyre.*
- *Ndërtimi i sistemeve të monitorimit dhe kontrollit, programe sistematike të detektimit të rrjedhjeve, Instalimi dhe mirëmbajtja e matësve si në depo , rrjet dhe tek klientët.*
- *Fushata sensibilizuese për konsumatorët mbi raportimin e defekteve dhe rëndësinë e matesave. Zbatimi rigoroz i kontratave dhe tarifave, duke shmangur tolerancën për pagesat e pakryera.*
- *Shoqëritë duhet të evidentojné dhe përfshijnë sasinë e ujit falas (që subvencionohet) si një konsum të faturuar (me tarifë zero) dhe kjo sasi nuk shkon automatikisht si “humbje” vetëm*

se nuk paguhet; por duhet të dokumentohet dhe të shënohet si pjesë e konsumit të autorizuar.

Si përfundim, shoqëritë rajonale duhet të kalojnë nga një menaxhim tradicional (riparime vetëm kur ka difekte) drejt një menaxhimi pro aktiv dhe llogaritës, ku çdo litër ujë i prodhuar të gjurmohet dhe të shfrytëzohet me efikasitet maksimal. Bashkëpunimi midis gjithë palëve të interesuara, përdorimi i praktikave të qëndrueshme dhe investimi në infrastrukturë dhe teknologji të përshtatshme mund të ndihmojnë në zvogëlimin e humbjeve të ujit nga shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve.

3. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Berat

Shoqëria rajonale UK Berat e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK ose Njësitë, përkatësisht UK Berat me 23.01%, UK Kuçovë me 12.32%, UK Dimal me 5.39%, UK Poliçan me 3.58%, dhe UK Skrapar me 4.7%.

Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh R UK Berat jepen në tabelën 4.

Nga të dhënat e Tabelës 4, referuar raportimeve të shoqërive pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 67.1 l/ditë për banorë, apo sipas faturimit aforfe që rezulton një konsum prej 33.5 l/ditë për banor, është shumë i ulët dhe larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor.

Këto vlera tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben dhe në juridiksion, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor, ose të shpjegojë arsyet e këtij nën faturimi.

Tabela 4. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Berat	Popullsia e Shërbyer	Konsumi Total (në m ³)	Konsumi i Matur (në m ³)	Konsumi Pamatur (në m ³)	Lidhjet me matës	Lidhjet pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							(l/ditë, banor)		
2024	159,062	3,735,300	3,577,000	158,300	35,991	3,187	67.1	33.5	64.3

Referuar tendencës në rritje të vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve demografike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale.

Për këtë qëllim në Tabelën 5, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre. Edhe për 2024 kemi mbajtur të njëjtën parametër të kapaciteteve të burimeve për ujë të pijshëm, pasi nuk ka një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela 5. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh .R. UK Berat	Popullsia e Shërbyer*	Uji i Prodhuar qe futet ne sistem (ne m³)	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe (l/ditë, banor)	Popullsia e Regjistruar ne Zonën e Shërbimit*	Kapaciteti i Burimit (në m³/vit)	Sasia e Disponueshme e Ujit (l/ditë, banor)	Diferenca ne Plotësimin e Kërkesës (l/ditë, banor)
2024	159,062	6,899,000	64.3	228,654	100,446,000	+ 1203.5	+ 1139.2

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga tabela 5, shihet se shoqëria rajonale UK Berat ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitet përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Berat

Shoqëria Rajonale UK Berat, është krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Berat - Kuçovë, Poliçan, Skrapar dhe Dimal. Shërbimin i FU i ofrohet 159,062 banorëve ose **69.56 %** të popullsisë në juridiksion. Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë për vitin 2024 raportohet **42,750 lidhje** nga të cilat 92.18 % janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor 6,899,000 m³ rezulton i matur në nivelin 21.6 %, nevoja për aparateve ujëmatës në pikat prodhuese është e domosdoshme për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

“Uji Pa të Ardhura” rezultoi në nivelin 37.67 % të ujit që hyn në sistem, shoqëria faturon vetëm 4,299,822 m³ ujë ose 62.33 % të prodhimit.

Në Tabelën 6, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Berat.

Tabela 6. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Berat – Viti 2024.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	6,899,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	4,084,822	59.21%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	215,000	3.12%
Faturimi total	4,299,822	62.33%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	544,835	7.90%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	245,280	3.56%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	378,423	5.49%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	136,840	1.98%
Humbjet e dukshme (administrative)	760,543	11.02%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	127,786	1.85%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	141,912	2.06%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	264,771	3.84%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	292,000	4.23%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	467,331	6.77%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,293,800	18.75%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	2,054,343	29.78%
UJI PA TË ARDHURA	2,599,178	37.67%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 6:

- Treguesi UPA për vitin 2024 në nivelin 37.67 % ka pësuar një përmirësim të ndjeshëm me 8.97 % krahasuar me vitin 2023. Humbjet totale u raportuan me 29.78 % të prodhimit vjetor të ujit nga 40.29% që rezultojnë në vitin 2023.
- Nga humbjet totale rezultojnë se 11.2 % janë humbjet e dukshme (administrative) dhe 18.75% janë humbjet reale (teknike).
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i prodhuar” në nivelin 21.6 %, bën të pa besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit në nivelin 3.56% pasqyrojnë një trend pozitiv (d.m.th. ulje të tyre) krahasuar me vitin 2023 që ishin në vlerën 5.09% nuk konsiderohen të besueshme dhe duhen verifikuar në terren.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës në masën 5.49% janë pothuaj të pandryshueshme krahasuar me vitin 2023 që ishin në nivelin 5.66%.
- Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit nën faturim etj. raportohet në vlerën 1.98% me një tendencë të vogël përqendrimi pasi në vitin 2023 janë raportuar në masën 1.19% .

- Në humbjet teknike, 4.23 % raportohen humbjet për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes e cila ka një trend në përmirësim krahasuar me vitin 2023, e cila ka qenë 10.40%.
- Konsumatorët familjarë me matje përbëjnë rreth 84.2 % me një rritje 1.42 % nga viti 2023, të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa më afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi nga stafet për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që vetëm 21.6 % e ujit të prodhuar matet, shoqëria duhet të marrë masa për investime në ujëmatës në prodhim qoftë me fonde nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj, për instalimin e tyre në të gjithë burimet që shfrytëzon për prodhimin e ujit. Gjithashtu, sa duhet të insistojë në pajisjen me matësa, inteligjentë dhe të kalibruar në të gjithë klientët e saj, kryesisht familjar, pasi rezulton se treguesi “Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim” nuk ka ndryshuar përgjatë viti 2023-2024.*
- *Nevojiten përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojnë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme.*
- *Te hartohet një plan veprimi me prioritet instalimin e matësave në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*

- *Shoqëria duhet të paraqesë justifikim për vëllimet e raportuara dhe të parashikuara të konsumit të autorizuar të pafaturuar, pasi për vitin 2024 është 7.9% dhe vëllimi i raportuar dhe i parashikuar i këtij konsumi apriori nuk duhet të kalojë 4% të vëllimit të ujit që hyn në sistem.*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës, dhe riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës, vihet re një trend pozitiv (pra një zvogëlim i tyre) nevojitet evidentimi nëse janë probleme të gjendjes fizike jo të mirë të rrjetit kryesor, sidomos për zonën rurale, dhe prioritizimi i zëvendësimit të tyre sipas moshës, materialit dhe historikut të defekteve të tyre, shoqëruar me planifikim fondesh nga shoqëria për rehabilitimin e tyre. Këto masa do të ndikojnë në uljen e UPA.*
- *Nga ana e shoqërisë duhet të ndërmerren plane veprimi për mbrojtjen dhe diversifikimin e burimeve të ujit si dhe për edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut në përdorimin e qëndrueshëm të ujit, apo aplikimi i metodave teknologjike (celularë) në raportimin real të defekteve apo shpërdorimeve nga vetë klientët.*
- *Duke qënë se shoqëria ka nën administrim 5 njësi administrative, problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikës në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë që nga matja e ujit të prodhuar dhe deri tek sasia që merr çdo konsumator, do të shërbente si guidë për shoqërinë për përmirësimin e nivelit të humbjeve si ato administrative dhe ato reale në të gjithë zonën e juridiksionit të saj.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo fillim viti për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë. Të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.*

4. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Dibër

Shoqëria rajonale UK Dibër përbëhet nga ish shoqëritë UK ose Njësitë administrative UK Dibër, UK Mat, UK Bulqizë dhe UK Klos.

Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh R UK Dibër jepen në tabelën 7.

Nga të dhënat e Tabelës 7, referuar raportimeve të shoqërive pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 108.8 l/ditë për banorë, apo sipas faturimit aforfe që rezulton një konsum prej 134.1 l/ditë për banor, është larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor *(megjithatë mund të cilësohet si sasi e mjaftueshme përsa i përket konsumit mesatar ditor)*.

Këto vlera tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben dhe në juridiksion, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor, ose të shpjegojë arsyet e këtij nën faturimi.

Tabela 7. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R UK Dibër	Popullsia e Shërbyer	Konsumi Total (në m ³)	Konsumi i Matur (në m ³)	Konsumi Pamatur (në m ³)	Lidhjet me matës	Lidhjet pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							(l/ditë, banor)		
2024	92,475	3,972,000	2,383,000	1,589,000	14,384	7,779	108.8	134.1	117.7

Referuar tendencës në rritje të vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve demografike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën 8, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre. Edhe për 2024 kemi mbajtur të njëjtën parametër të kapaciteteve të burimeve për ujë të pijshëm, pasi nuk ka një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela 8. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh .R. UK Dibër	Popullsia e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futet ne sistem (ne m ³)	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe (l/ditë, banor)	Popullsia e Regjistruar ne Zonën e Shërbimit	Kapaciteti i Burimit (në m ³ /vit)	Sasia e Disponueshme e Ujit (l/ditë, banor)	Diferenca ne Plotësimin e Kërkesës (l/ditë, banor)
2024	92,475	6,403,000	117.7	170,573	14,212,078	+ 228.3	+ 110.6

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga tabela 8, shihet se shoqëria rajonale UK Dibër ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Dibër

Shoqëria Rajonale UK Dibër, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Dibër, Mat, Bulqizë dhe Klos, raporton një popullsi në juridiksion 170,573 banorë.

Popullsia që mbulohet me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 92,475 banorë ose 54.21% të popullsisë totale. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 24,108 lidhje, nga të cilat 15,912 lidhje ose 66 % janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor është 6,403,000 m³ dhe është 100% i vlerësuar, nevoja për aparate ujëmatës në pikat prodhuese është imediate për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

Uji Pa të Ardhura është në nivelin 27.16 % të ujit që hyn në sistem për vitin 2024 nga 49.31 % që rezultonte në vitin 2023 dhe shoqëria faturon vetëm 4,664,000 m³ ose 72.84 % nga 3,644,000 m³ ujë ose 50.69 % të prodhimit në vitin 2023 (kjo falë investimit të ri të përfunduar në këtë shoqëri). Tabela 9, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Dibër.

Tabela 9. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Dibër – Viti 2024

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	6,403,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,967,000	46.34%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,697,000	26.50%
Faturimi Total	4,664,000	72.84%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	107,991	1.69%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	250,662	3.91%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	117,268	1.83%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	723,560	11.30%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	1,091,490	17.05%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	12,450	0.19%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	12,300	0.19%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	12,340	0.19%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	350,000	5.47%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës	152,429	2.38%
Humbjet Reale (Teknike)	539,519	8.43%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	1,631,009	25.47%
UJI PA TË ARDHURA	1,739,000	27.16%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 9:

- Treguesi UPA në nivelin 27.16 % me një përmirësim të ndjeshëm me 22.15 % nga viti 2023 ku humbjet ishin 49.31 % të prodhimit vjetor është arritur falë përfundimit të investimeve në këtë shoqëri dhe rritjes së faturimit.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i Prodhuar” vazhdon të jetë zero, kjo i bën të pabesueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit.
- Konsumi total i faturuar është në nivelin 72.84 % , prej të cilit 26.50 % është konsum i faturuar i pamatur, tregues ky që krahasuar me vitin 2023 që rezultonte 50.69 % , tregon përmirësim të ndjeshëm falë përfundimit të investimeve që janë bërë në këtë shoqëri.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 15,912 klientë dhe përbëjnë 66 % të totalit të klientëve që ka kjo shoqëri. Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 59.52 % të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa me afër nivelit 100% të matjes.
- Niveli i humbjeve reale është 8.43 % duke paraqitur një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin 2023 që këto humbje ishin në nivelin 26.1 % dhe që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 5.47 % . Shoqëria duhet të japi argumenta të mëtijshme për justifikimin e tyre, të analizojë dhe të monitorojë situatën në terren për mundësinë e uljes së tyre.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 17.05 % e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, nga e cila pjesën më të madhe e zënë humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin 11.30 %.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi stafi has mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.

Pra nga analiza e bilancit të ujit vihet re se në këtë shoqëri rajonale komponenti që zë peshën më të madhe të humbjeve janë humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin 11.30 % dhe humbjet nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 5.47 % , që mund të vij nga rrjetet e amortizuara në zonat kryesisht jo urbane duke nxjerrë në pah dhe nevojën për investime.

Rekomandime:

- *Pajisja me ujëmatës në burim vazhdon të mbetet një nevojë imediate dhe e domosdoshme për investime në ujëmatës në prodhim, ndaj shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, evidentim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës (me prioritet instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale) që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, pavarësisht se ato raportohen në disa raste mjaft të ulta dhe të pabesueshme.*
- *Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banoreve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës, por dhe në rrjetin e transmetimit duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit dhe të planifikohen fonde nga shoqëria për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktimin e treguesit të Ujit Pa të Ardhura.*
- *Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturimi etj. të cilat janë në nivelin 11.3 % të ujit të prodhuar, shoqëria duhet të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin tek matësat apo tek nën faturimi duke kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësve.*
- *Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilanci të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*

- Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej.
- Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo fillim viti për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë. Të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.

5. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Durrës

Shoqëria rajonale UK Durrës përbëhet nga ish shoqëritë UK ose Njësitë, përkatësisht UK Durrës, Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë.

Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh R UK Durrës jepen në tabelën 10.

Nga të dhënat e Tabelës 10, referuar raportimeve të shoqërive pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 55.9 l/ditë për banorë, apo sipas faturimit aforfe që rezulton një konsum prej 134.1 l/ditë për banor, është larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor veçanërisht konsumi i matur.

Këto vlera tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben dhe në juridiksion, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor, ose të shpjegojë arsyet e këtij nën faturimi.

Tabela 10. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Durrës	Popullsia me shërbim	Konsumi total ne m ³	Konsumi I matur ne m ³	Konsumi I pamatur ne m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr.lidhjeve pa mates	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
2024	491,284	10,845,400	9,434,579	1,410,821	118,185	7,365	55.9	134.1	60.5

Referuar tendencës në rritje të vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve demografike, duhet bërë

një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën 11, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre. Edhe për 2024 kemi mbajtur të njëjtën parametër të kapaciteteve të burimeve për ujë të pijshëm, pasi nuk ka një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela 11. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Durrës	Popullsia e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
2024	491,284	52,012,120	60.5	577,663	39,068,500	+ 185.3	+ 124.8

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga tabela 11 shihet se shoqëria rajonale UK Durrës ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Durrës

Shoqëria Rajonale UK Durrës, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë, ka nën juridiksion 577,663 banorë. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 491,284 banorë ose 85.5 % të popullsisë totale. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 136,114 lidhje (4341 lidhje më shumë se në vitin 2023), nga të cilat 128,417 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës me një rritje prej 7,500 lidhje më shumë për këtë vit.

Prodhimi vjetor 52,012,120 m³ rezulton i matur në nivelin 74.3 %, nevoja për aparateve ujëmatës në pikat prodhuese është imediate. **Uji Pa të Ardhura rezulton në nivelin 67,32 %** të ujit që hyn në sistem dhe faturohet vetëm në nivelin 32,68 % të prodhimit.

Tabela 12, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Durrës.

Tabela 12. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Durrës – Viti 2024

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	52,012,120	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	15,549,122	29.90%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,447,736	2.78%
Faturimi total	16,996,858	32.68%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	-	0.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	8,729,636	16.78%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	4,159,273	8.00%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	2,780,909	5.35%
Humbjet e dukshme (administrative)	15,669,818	30.13%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	2,418,182	4.65%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	483,636	0.93%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	483,636	0.93%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	14,992,727	28.83%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	967,273	1.86%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	19,345,454	37.19%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	35,015,272	67.32%
UJI PA TË ARDHURA	35,015,272	67.32%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 12:

- Për vitin 2024 treguesi UPA është në nivelin 67.32 % nga 72.39 % që ishte në vitin 2023 të prodhimit vjetor, me një përmirësim 5.07 % por ende është në nivele mjaft të pakënaqshëm dhe kërkon angazhim serioz pasi rrezikon qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i prodhuar” 74.3% si dhe konsumi i matur nga faturimi total është 91.48 %. Kërkohej impenjim dhe planifikim të fondeve deri sa të arrihet matja 100% e prodhimit.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit 16.78% dhe atë të shpërndarjes prej 8 % janë në nivele të larta dhe me një përmirësim shumë të vogël krahasuar me vitin 2023 dhe kërkojnë ndërhyrje urgjente nëpërmjet task-forcës për përmirësim për të patur shërbim cilësor të furnizimit me ujë.
- Humbjet teknike 37.19 % konsiderohen të larta dhe në nivele të pa pranueshme që duhen përmirësuar, shkaktohen kryesisht nga humbjet në rrjetin e shpërndarjes 28.83 % dhe të transmetimit 4.65 % për të cilat shoqëria duhet të bëjë analizën e duhur për të gjetur arsyet dhe zgjidhjet e duhura për reduktimin e tyre.

- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve kryhet pjesërisht me zona të ndara me matje (DMA), në përgjithësi hasen vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit nga të gjitha njësitet që përbëjnë shoqërinë rajonale. Trajnimi i stafit është i domosdoshëm për me tepër për ish shoqëritë UK Krujë, Kavajë dhe Rrogozhinë.

Nga analiza e bilancit të ujit vihet re se në këtë shoqëri rajonale komponenti që zë peshën më të madhe të humbjeve janë humbjet në rrjetin e shpërndarjes 28.83 %, humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit 16.78% dhe atë të shpërndarjes prej 8 %, humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj. me 5.35 % si dhe humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit 4.65 % duke nxjerrë në pah dhe nevojën për investime dhe mbi të gjitha një menaxhim dhe ndërhyrje urgjente nëpërmjet task-forcës për përmirësim të humbjeve nga lidhjet e paligjshme për të patur shërbim cilësor të furnizimit me ujë.

Rekomandime:

- *Pajisja me ujëmatës në burim vazhdon të mbetet një nevojë imediate dhe e domosdoshme për investime në ujëmatës në prodhim, ndaj shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë të cilat mundësojnë një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe me gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, të cilat janë në nivele të larta e të papranueshme për UK Rajonale Durrës.*
- *Hartimi i një plan veprimi me prioritete instalimin e matësave në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*

- Në lidhje me përqindjen e lartë të lidhjeve të paligjshme 16.78 %, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa me saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHE-së.
- Të ngrihet një Task Forcë e cila vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësive dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikës me ujin e nën faturuar.
- Të krijohet dhe të mirëmbahet të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej.
- Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës janë në nivel shumë të lartë prej 28.83%. Duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit dhe të planifikohen fonde nga shoqëria për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktimin e treguesit të Ujit Pa të Ardhura.
- Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo fillim viti për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë. Të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.

6. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan

Shoqëria Rajonale UK Elbasan u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK Elbasan, UK Librazhd, UK Gramsh, UK Cërrik, UK Belsh dhe UK Peqin. Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh R UK Elbasan jepen në tabelën 13.

Nga të dhënat e Tabelës 13, referuar raportimeve të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 72.1 l/ditë për banorë, apo sipas faturimit aforfe që rezulton një konsum prej 81.7 l/ditë për banor, është larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor.

Këto vlera tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben dhe në juridiksion, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe

klientët jo aktivë), sepse për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor, ose të shpjegojë arsyet e këtij nën faturimi.

Tabela 13. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. Elbasan	Popullsia me shërbim	konsumi total ne m3	Konsumi i matur ne m3	Konsumi i pamatur ne m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/dite, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
2024	256,257	6,823,000	6,065,000	767,000	56,568	6,313	72.1	81.7	73.0

Referuar tendencës në rritje të vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve demografike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën 14, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre. Edhe për 2024 kemi mbajtur të njëjtën parametër të kapaciteteve të burimeve për ujë të pijshëm, pasi nuk ka një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela 14. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. Elbasan	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(l/ditë, banor)		(në m3/vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2024	256,257	21,034,000	73	401,282	62,692,462	+428.0	+355.0

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga Tabela 14, shihet se shoqëria rajonale UK Elbasan, referuar të dhënave të shoqërisë të raportuara pranë sektorit të monitorimit, për numrin e popullsisë me shërbim dhe atë të regjistruar në juridiksion rezulton se ka burime të disponueshme uji. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshëm, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve të ujit në të gjitha njësitë përbërëse, për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit më ujë 24/7” i cili raportohet për të dytin viti radhazi në vlerën prej 18 orë.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan

Shoqëria Rajonale UK Elbasan, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Elbasan, Belsh, Cërrik, Gramsh, Peqin dhe Librazhd ofron shërbimin e mbulimit me ujë për 256,257 banorë ose 63.9%.

Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë në total raportohet 69,344 lidhje, nga të cilat 62,853 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës ose 90.6% e tyre nga 88.96 % që rezultoi në vitin 2023.

Prodhimi vjetor është 21,035,000 m³ dhe rezulton *i matur në nivelin e 88.2% e prodhimit*, pjesa tjetër e sasisë së ujit që hyn në sistem vlerësohet. Nevoja për aparateve ujëmatës në pikat prodhuese është imediate për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

Uji Pa të Ardhura rezultoi në nivelin 62.45 % nga 69.46 % në vitin 2023, të sasisë së ujit që hyn në sistem, duke reflektuar një përmirësim të treguesit UPA me 7.01%. Shoqëria faturon vetëm 7,898,000 m³ ujë ose 37.55% të prodhimit nga 30.54 % që rezultonte në vitin 2023.

Tabela 15, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Elbasan.

Tabela 15. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan – Viti 2024

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	21,034,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	7,125,000	33.87%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	773,000	3.68%
Faturimi total	7,898,000	37.55%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	1,169,104	5.56%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	656,800	3.12%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	2,364,480	11.24%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	3,284,000	15.61%
Humbjet e dukshme (administrative)	6,305,280	29.98%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	656,800	3.12%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	788,160	3.75%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	394,080	1.87%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	2,364,480	11.24%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	1,458,096	6.93%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	5,661,616	26.92%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	11,966,896	56.89%
UJI PA TË ARDHURA	13,136,000	62.45%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 15 :

- Treguesi UPA në nivelin 62.45 % të prodhimit vjetor, vazhdon të mbetet shumë i lartë dhe që duhet përmirësuar me përparësi.
- “Uji i Prodhuar” i matur është në nivelin 88.2 % pjesa tjetër e sasisë së ujit që hyn në sistem vlerësohet.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës në nivelin 11.24 % tregojnë një tendencë përmirësimi krahasuar me nivelin prej 17.79 % që ishin në vitin 2023, por përsëri mbeten të larta e të papranueshme.
- Nga Humbjet totale prej 56.89 %, Humbjet e dukshme (administrative) zënë 29.98 % që konsiderohen mjaft të larta prandaj duhen dhënë argumenta të mëtijshme për justifikimin e tyre, ndërsa Humbjet Reale (teknike) 26.92 %.
- Tek Humbjet e dukshme pjesën më të madhe e zënë “Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.” me 15.61% duke paraqitur një trend rritës (negativ) krahasuar me vitin 2023 që ishte në nivelin e 14.67%. Humbjet ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës me 15.61% nga 17.79 % në vitin 2023 megjithëse me trend zbritës mbeten ende në nivele shumë të larta dhe të patolerueshme.
- Përsa i përket humbjeve reale peshën më të madhe e zënë Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes me 11.24 % nga 14.92% të paraqitur në vitin 2023, por vihet re një rritje/përkeqësim i nivelit të humbjeve për shkak të riparimeve në linjat e ujësjellësit në nivelin 6.93% nga 5.76% në vitin 2023.
- Ajo çfarë vihet re është dhe rritja e Konsumit të autorizuar të pafaturuar në nivelin 5.56% nga 1.94% që ka qenë në vitin 2023, duke qenë një faktor i qenësishëm në nivelin e UPA.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.

Rekomandime:

- *Të angazhohet maksimalisht për trajnimin e stafit teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit, për analizimin e tyre saktë dhe real, me prioritet personat përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, gjatë hartimit të bilancit të ujit për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Shoqëria duhet të vazhdojë angazhimin e saj për kryerjen e investimeve për instalimin e matësve jo vetëm atyre të mëdhenj (në prodhim) por edhe ato individuale në rrjetin e shpërndarjes, në mënyrë që të ketë një matje sa më të saktë të ujit të prodhuar apo të sasisë së ujit që faturohet, pasi kështu mund të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Shoqëria duhet të përpiqet për gjetjen e fondeve për instalimin e matësve tek konsumatorët familjare në mënyrë që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100 %, sidomos matësve inteligjent, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme sidomos atyre nga pasaktësitë në matje, apo nënfaturim. Prioritet duhet t'i kushtohet instalimit të tyre në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Shoqëria duhet të paraqesë justifikim për vëllimet e raportuara dhe të parashikuara të konsumit të autorizuar të pafaturuar, pasi për vitin 2024 është 5.56% dhe vëllimi i raportuar dhe i parashikuar i këtij konsumi apriori nuk duhet të kalojë 4% të vëllimit të ujit që hyn në sistem.*
- *Niveli i lartë i lidhjeve të paligjshme, kërkon nga shoqëria hartimin dhe zbatimin e një plani konkret veprimi për të përcaktuar sa më saktë bazën e klientëve dhe në bashkëpunim me Taks -Forcën e ngritur me mbështetjen e njësive respektive të qeverisjes vendore, të jetë në veprim në terren, me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, të kontrollojë punën e lexuesve të matësve dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikës me ujin e nën faturuar.*
- *Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banoreve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992. Të saktësohen numri i popullsisë së shërbimit dhe i zonës së juridiksionit, sepse vihet re që nuk korrespondojnë me ato të publikuara nga INSTAT dhe kjo sjell një të analizë joreale të situatës lidhur me përdorimin e ujit.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe dorëzimin në kohë pranë ERRU-se. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo fillim viti.*

7. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Fier

Shoqëria rajonale UK Fier u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK ose Njësitë, përkatësisht UK Fier, Patos, Roskovec dhe Mallakastër. Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh R UK Fier jepen në tabelën 16.

Nga të dhënat e Tabelës 16, referuar raportimeve të shoqërive pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 65.2 l/ditë për banorë, ndërsa sipas faturimit aforfe që rezulton një konsum prej 101.2 l/ditë për banor, është larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor.

Këto vlera tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben dhe në juridiksion, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor, ose të shpjegojë arsyet e këtij nën faturimi.

Tabela 16. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Fier	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m ³	Konsumi i matur në m ³	Konsumi i pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me mates	Nr.lidhjeve pa mates	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
2024	200,172	5,277,920	3,830,790	1,447,130	40253	9,790	65.2	101.2	72.2

Referuar tendencës në rritje të vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve demografike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën 17, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre. Edhe për 2024 kemi mbajtur të njëjtën parametër të kapaciteteve të burimeve për ujë të pijshëm, pasi nuk ka një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela 17. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh .R. UK Fier	Popullsia e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futet ne sistem (në m ³)	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe (l/ditë, banor)	Popullsia e Regjistruar ne Zonën e Shërbimit	Kapaciteti i Burimit (në m ³ /vit)	Sasia e Disponueshme e Ujit (l/ditë, banor)	Diferenca ne Plotësimin e Kërkesës (l/ditë, banor)
2024	200,172	15,970,320	72.2	323,508	48,053,000	+ 407.0	+ 334.8

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga tabela 17 shihet se shoqëria rajonale UK Fier ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Fier

Shoqëria Rajonale UK Fier, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Fier, Patos, Roskovec dhe Mallakastër, ka nën juridiksion sipas raportimeve të vet shoqërisë, 323 508 banorë. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 200 172 banorë ose 61.88 % të popullsisë totale. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 54,811 lidhje në total, nga të cilat 50.043 janë lidhje familjare ku me matje janë vetëm 40,253 lidhje ose 80.44 % me një rritje të papërfillshme me 0.64 % nga viti 2023.

Prodhimi vjetor 15,970,320 m³ rezulton i matur në nivelin 100 %, çka tregon se për të gjitha burimet e shfrytëzueshme ka aparate ujëmatës në pikat prodhuese.

“Uji Pa të Ardhura” rezultoi në nivelin 61.47 % të ujit që hyn në sistem me një përmirësim fare të vogël prej 4.2 % krahasuar me vitin 2023. Shoqëria faturon vetëm 6.153.860 m³ ujë ose 38.53 % të prodhimit. **Tabela 18** paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Fier.

Tabela 18. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Fier – Viti 2024.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	15,970,320	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	4,652,516	29.13%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,501,344	9.40%
Faturimi total	6,153,860	38.53%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	309,460	1.94%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	1,580,000	9.89%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	4,000,000	25.05%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	1,350,000	8.45%
Humbjet e dukshme (administrative)	6,930,000	43.39%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	190,000	1.19%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	130,000	0.81%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	180,000	1.13%

Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	1,750,000	10.96%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	327,000	2.05%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	2,577,000	16.14%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	9,507,000	59.53%
UJI PA TË ARDHURA	9,816,460	61.47%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 18:

- Treguesi UPA në nivelin 61.47 % të prodhimit vjetor për vitin 2024, konsiderohet shumë i lartë dhe që duhet përmirësuar pasi niveli prej 4.2 % i përmirësimi për këtë vit është shumë i ulët.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e shpërndarjes 25.05 % dhe të transmetimit 9.89% janë në nivele shumë të larta dhe në përkeqësim nga viti 2023 dhe që duhen verifikuar në terren për nivelin real të tyre.
- Në humbjet teknike, humbjet nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes 10.96 % të prodhimit vjetor konsiderohen mjaft e lartë për te cilat duhen dhënë argumente të mëtijshme për justifikimin e tyre.
- Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 73.44 % të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa më afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit, kjo gjë është konstatuar nga të gjitha njësitë që përbëjnë këtë shoqëri rajonale.

Rekomandime:

- *Duhet të vazhdojnë përpjekjet nga ana e shoqërisë për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojnë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*

- Në lidhje me përqindjen e lartë të lidhjeve të paligjshme si në rrjetin shpërndarës ashtu dhe në rrjetin e transmetimit, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHE-së.
- Të ngrihet një Task Forcë e cila vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësive dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e nën faturuar.
- Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa me afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme.
- Hartimi i një plan veprimi me prioritet instalimin e matësive në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.
- Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohet.
- Të planifikojë investime në ujëmatës për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, për të patur konsum të matur për çdo lidhje uji që faturohet.
- Për korrigjimin e normave të faturimit me matje, shoqëria duhet të angazhohet në gjetjen e lidhjeve dyfishe. Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.
- Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikës në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë.
- Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo fillim viti për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë. Të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.

8. Analiza e “Uji Pa të Ardhura” (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë

Shoqëria rajonale UK Gjirokastrë u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK ose Njësitë, përkatësisht UK Gjirokastrë, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull dhe Memaliaj.

Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh R UK Gjirokastrë jepen në tabelën 19.

Nga të dhënat e Tabelës 19, referuar raportimeve të shoqërive pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 71.8 l/ditë për banorë, apo sipas faturimit aforfe që rezulton një konsum prej 117.7 l/ditë për banor, është larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor veçanërisht konsumi i matur.

Këto vlera tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben dhe në juridiksion, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor, ose të shpjegojë arsyet e këtij nën faturimi.

Tabela 19. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare më Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Gjirokastrë	Popullsia me shërbim	Konsumi total ne m ³	Konsumi I matur ne m ³	Konsumi I pamatur ne m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/dite, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2024	114,204	3,592,770	2,053,640	1,539,130	19,580	8,946	71.8	117.7	86.2

Referuar tendencës në rritje të vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve demografike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën 20, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre. Edhe për 2024 kemi mbajtur të njëjtën parametër të kapaciteteve të burimeve për ujë të pijshëm, pasi nuk ka një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela 20. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Gjirokastrë	Popullsia e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2024	114,204	6,382,000	86.2	145,355	44,136,000	+ 831.9	+ 745.7

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga tabela 20, shihet se shoqëria rajonale UK Gjirokastrë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitet përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë

Shoqëria Rajonale UK Gjirokastrë, u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK Gjirokastrë, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull dhe UK Memaliaj. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 114,204 banorë ose 78.57 % të popullsisë totale. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 31,373 lidhje, nga të cilat 22,289 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor 6,382,000 m³ rezulton i matur në nivelin 55.61 %, nevoja për aparate ujëmatës në pikat prodhuese është imediate pothuajse për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

Uji Pa të Ardhura rezultoi në nivelin 35.57 % të ujit që hyn në sistem nga 42.55 % raportuar në vitin 2023.

Shoqëria faturon vetëm 4,112,000 m³ ose 64.43 % të prodhimit nga 4,058,638 m³ ujë ose 57,45 % në vitin 2023.

Tabela 21, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Gjirokastrë.

Tabela 21. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë – Viti 2024

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	6,382,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,506,200	39.27%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,605,800	25.16%
Faturimi total	4,112,000	64.43%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	72,000	1.13%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	-	0.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	-	0.00%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	234,000	3.67%
Humbjet e dukshme (administrative)	234,000	3.67%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	454,000	7.11%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	201,418	3.16%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	404,260	6.33%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	473,941	7.43%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	430,500	6.75%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,964,119	30.78%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	2,198,119	34.44%
UJI PA TË ARDHURA	2,270,119	35.57%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 21:

- Treguesi UPA në nivelin 35.57 % të prodhimit vjetor megjithëse në trend zbritës krahasuar me vitin 2023 që rezultonte 42.55%, ndonëse nën mesataren e sektorit për të gjithë vendin, sërisht duhet punë për të përmirësuar humbjet në të gjithë zonën që shërben shoqëria.
- “Uji i prodhuar”, matet në nivelin 55.61 % me një rritje prej 10.61 % nga viti 2023 por sërisht është shumë i ulët, gjë e cila bën të pa besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit.
- Humbjet administrative rezultojnë të jenë si rezultat i nënfaturimit, apo pasaktësive në lexim të ujëmatësave me 3.67 %, ndërkohë që humbjet nga lidhjet e paligjshme si në rrjetin e transmetimit ashtu dhe në rrjetin shpërndarës janë zero për të disatin vit radhazi por që e bën të dyshimtë situatën pasi dhe vet zona e shoqërisë rajonale është me një shtrirje shumë të madhe dhe është e dyshimtë që të jenë zero lidhjet e paligjshme.
- Humbjet teknike në nivel prej 30.78 % konsiderohen mjaft të larta dhe për të disatin vit radhazi në të njëjtat nivele, ndaj duhen dhënë argumente të mëtijshme për justifikimin e tyre.

- Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 68.64 % të numrit total të konsumatorëve familjare, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa më afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.

Rekomandime:

- *Nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, duke patur parasysh që pjesa më e madhe e burimeve të furnizimit me ujë nuk janë të pajisur me ujëmatës. Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real që do të përcaktojë më pas dhe nivelin real të UPA.*
- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilanci të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, pavarësisht se ato raportohen në disa raste mjaft të ulta dhe të pabesueshme.*
- *Hartimi i një plan veprimi me prioritete instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Të ngrihet një Task Forcë e cila vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësve dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e nën faturuar.*

- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej.*
- *Të planifikojë investime në ujëmatës për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, për të patur konsum të matur për çdo lidhje uji që faturohet.*
- *Për korrigjimin e normave të faturimit me matje, shoqëria duhet të angazhohet në gjetjen e lidhjeve dyfishe. Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare aktuale) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*
- *Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikës në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo fillim viti për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë. Të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.*

9. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Korçë

Shoqëria Rajonale UK Korçë krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Korçë, Devoll, Maliq, Pustec dhe Kolonjë ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 175,582 banorëve ose 83.7% të popullsisë në juridiksion sipas raportimit pranë sektorit të monitorimit. Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë për vitin 2024 raportohet 55,232 lidhje, nga të cilat 53,129 lidhje ose 96.2% janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor prej 7,690,730 m³ rezulton pothuajse 65.41% i matur dhe pjesa tjetër i vlerësuar, pra është imediate nevoja për Ujëmatësa në pikat prodhuese (burime).

Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Korçë jepen në tabelën 22.

Nga të dhënat e Tabelës 22, vërehen probleme me faturimin aforfe sepse dihet që konsumi mesatar për banor për këtë lloj faturimi referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 duhet të jetë 150 litra/banor në ditë, ndërkohë që nga tabela rezulton që konsumi aforfe është në vlera shumë të ulëta. Referuar po këtij vendimi, shoqëria rajonale UK Korçë, duhet të analizojnë me kujdes të dhënat mbi volumet

e faturuara dhe numrin e klientëve të faturuar aforfe, për të gjetur dhe arsyet e nën faturimit të tyre.

Tabela 22. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe.

Sh.R. Korce	Popullsia me shërbim	Konsumi total ne m3	Konsumi i matur në m3	Konsumi i pamatur ne m3	Nr. lidhjeve me matës	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2024	223,859	4,507,400	4,430,000	77,400	49,293	1,903	56.5	23.4	55.2

Nga ana tjetër referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë. Për këtë qëllim në Tabelën 23, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe kapaciteti i burimeve ujore për gjithë zonën e juridiksionit të shoqërisë rajonale, duke marr dhe numrin e popullsisë sipas të dhënave të raportuara nga shoqëria. Vlen të sqarojmë se nuk kemi një pasqyrim real të kapaciteteve të burimeve ujore (kemi konsideruar vlerën e viteve të mëparshme), ndaj dhe një angazhim serioz në përcaktim e ecursisë së këtyre burimeve dhe qëndrueshmërisë së tyre është e nevojshme të ndërmerret nga ana e shoqërisë.

Tabela 23. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. Korce	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(l/ditë, banor)		(në m3/vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2024	223,859	7,690,730	55.2	226,121	23,235,528	+ 281.5	+ 226.3

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga Tabela 23, shihet se shoqëria rajonale UK Korçë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit, por vlen të theksohet se rezulton në nivele shumë të ulëta konsumi total dhe kjo sjell një vlerësim joreal të sasisë së disponueshme të ujit për banor në ditë, ndërkohë që edhe kapaciteti i burimeve është marrë i pandryshuar. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve të ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi.

UPA për ish Shoqërinë UK Korçë

Nga analiza e bërë referuar të dhënave të raportuara nga shoqëria pranë sektorit teknik dhe të verifikuara pranë sektorit të monitorimit rezulton se, Prodhimi vjetor prej 7,690,730 m³ rezulton i matur në nivelin 66.4% nga 64.18 % në vitin 2023. Shoqëria faturon vetëm 5,112,291 m³ ujë ose 66.47 % nga 64.18% të prodhimit, në vitin 2023. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit më ujë raportohet 55,232 lidhje, nga të cilat 96.1% janë të pajisur më aparate ujëmatës. Nevoja e aparateve ujëmatës në pikat prodhuese është e domosdoshme për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

“UPA” rezulton në nivelin 33.53 % nga 35.82 % që ka qenë në vitin 2023. Trendi zbritës tregon për një përmirësim të këtij treguesi dhe si një nivel më i mirë krahasuar me shoqëritë e tjera dhe afër mesatares kombëtare, vazhdon ta rendisë këtë shoqëri ndër kompanitë më të mira në shkallë kombëtare.

Referuar analizës teknike të shoqërisë(sipas modelit të aplikimit për nivel të ri tarifor) në qytetin e Korçës, krahas matësave që ndodhen në puse, në stacionin e pompave dhe në depo, ka dhe 7 matësa zonal të cilët ndodhen në rrjetin e qytetit. Këto DMA (zona të matura) janë krijuar për ato pjesë të rrjetit të cilat janë të hapura, pra jo unazore dhe kanë hyrje uji vetëm në një pikë. Pjesa tjetër e rajonit nuk ka DMA, por ka matje në dalje nga pusët, depot dhe stacionet për secilën qendër të banuar. Kjo ndodh për arsye se rrjetet e tjera, përjashtuar Korçën kanë një gjatësi relativisht të vogël dhe janë të kontrollueshme edhe me një matës.

Në tabelën 24, paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Korçë.

Tabela 24. Bilancit i Ujit për ish Shoqërinë Rajonale UK Korçë sh.a.- Viti 2024.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	7,690,730	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	5,030,142	65.41%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	82,149	1.07%
Faturimi total	5,112,291	66.47%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	-	0.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	-	0.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	467,349	6.08%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	384,536	5.00%
Humbjet e dukshme (administrative)	851,885	11.08%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	838,469	10.90%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	-	0.00%

Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	16,471	0.21%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	871,613	11.33%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	-	0.00%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,726,553	22.45%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	2,578,438	33.53%
UJI PA TË ARDHURA	2,578,438	33.53%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 24:

- UPA në nivelin 33.53% nga 35.82 % në vitin 2023 të prodhimit vjetor, konsiderohet në nivel të mirë në krahasim me nivelin mesatar të performancës së mire për sektorin në shkallë kombëtare.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i Prodhuar” në vlerën prej 70.3% nga 64.8% në vitin 2023, megjithëse me trend përmirësimi, kjo gjithësesi cenon vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht nivelin e besueshmërisë së treguesit UPA, pasi mungesa e matësive të ujit ndikon si në faturim ashtu dhe në cilësinë e shërbimit për konsumatorët, mungesë motivimi për kursim uji, apo konsum të panevojshëm.
- Konsumi total i faturuar është në nivelin 66.47 % nga 63.1%, prej të cilit vetëm 1.07 % nga 1.17% në vitin 2023 është konsum i faturuar i pamatur.
- Niveli i humbjeve reale është 22.45 % nga 21.49% në vitin 2023 të volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, ku zërin më të madh e zënë ato nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 11.33 % nga 11.49 % në vitin 2023 dhe nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit që nga 9.84% në vitin 2023 janë rritur në 10.9 %. Shoqëria duhet të analizojë dhe të argumentojë arsyet lidhur mbi këtë nivel humbjesh.
- Humbjet reale të ujit vlerësohen të jenë 1,726,553 m³ ose 22.45% të volumit të ujit të prodhuar dhe krahasuar me vitin 2023 që ishte në vlerën 21.49%, shpreh një përqendrim në masën (+0.96%) të këtij parametri në tërësi.
- Humbjet e Dukshme përbëjnë 11.08% të UPA, i cili paraqitet në vlerat 851,885 m³. Krahasuar me të dhënat e vitit të kaluar, ku humbjet e dukshme vlerësoheshin 14.33 % të UPA, rezultojnë që niveli i këtyre humbjeve të jetë ulur. Kështu nga analiza rezultojnë se humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit janë zëruar krahasuar me vitin 2023 ku kjo vlerë ishte 1.87%. Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës raportohen në masën 467,349 m³ ose 6.08% nga 7.46% në vitin 2023. Humbjet

e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit nën faturim etj. (384,536) ose 5% rezultojnë në të njëjtin nivel me vitin 2023.

- Numri i klientëve për shërbimin e furnizimit më ujë raportohet 55,224 lidhje, nga të cilat 92.6% janë të pajisur me aparate ujëmatës që përfitojnë këtë shërbim dhe rezulton të jetë edhe ky zë në të njëjtin nivel me vitin 2023.

Rekomandime:

- *Shoqëria duhet të punojë për një hartim të saktë të bilancit mujor dhe vjetor sipas modelit IWA bazuar në të dhënat nga sistemet SCADA dhe duke përdorur teknologjinë GIS për të monitoruar rrjetin në kohë reale.*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës, por edhe në rrjetin e transmetimit, ku vihet re një trend pozitiv (pra një zvogëlim i tyre) nevojitet evidentimi nëse janë probleme të gjendjes fizike jo të mirë të rrjetit kryesor, sidomos për zonën rurale, dhe prioritizimi i zëvendësimit të tyre sipas moshës, materialit dhe historikut të defekteve të tyre, shoqëruar me planifikim fondesh nga shoqëria për rehabilitimin e tyre. Këto masa do të ndikojnë në uljen e UPA.*
- *Hartimi i një Plani veprimi konkret me masat që do të merren për çdo njësi sipas problematikave që kanë që nga matja e ujit të prodhuar dhe deri tek sasia që merr çdo konsumator, do të shërbente si guidë për shoqërinë për përmirësimin e nivelit të humbjeve si ato administrative dhe ato reale në të gjithë zonën e juridiksionit të saj.*
- *Nevojiten përpjekje për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale që mundëson një evidentim, monitorim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Duke qenë se vetëm 70% ujit të prodhuar matet, shoqëria duhet të marrë masa për investime në ujëmatës në prodhim qoftë me fonde nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj, për instalimin e tyre në të gjithë burimet që shfrytëzon për prodhimin e ujit. Gjithashtu duhet të insistojë në pajisjen me matësa, inteligjentë dhe të kalibruar në të gjithë klientët e saj, kryesisht familjar, pasi rezulton se treguesi “Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim” nuk ka ndryshuar përgjatë viti 2023-2024.*
- *Nga ana e shoqërisë duhet të ndërmerren plane veprimi për mbrojtjen dhe diversifikimin e burimeve të ujit si dhe për edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut në përdorimin e*

qëndrueshëm të ujit, apo aplikimi i metodave teknologjike (celularë) në raportimin real të defekteve apo shpërdorimeve nga vetë klientët.

- *Për të ulur nivelet e UPA është thelbësore përcaktimi i shkallës së problemit, si dhe të përcaktohet dhe të identifikohet vendndodhja e zonave me nivelet më të lartë të UPA. Kjo mund të arrihet vetëm me verifikime dhe përdorimi i të dhënave të mjaftueshme dhe të sakta, në mënyrë periodike, shoqëruar me hartimin me përgjegjësi të bilancit të ujit për të përcaktuar një nivel bazë të humbjeve të ujit që nuk nuk gjeneron të ardhura.*
- *Të saktësohen numri i popullsisë së shërbimit dhe i zonës së juridiksionit, sepse vihet re që nuk korrespondojnë me ato të publikuara nga INSTAT dhe kjo sjell një të analizë joreale të situatës lidhur me përdorimin e ujit.*

10. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Kukës

Shoqëria rajonale UK Kukës u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK, përkatësisht UK Kukës, Tropojë dhe Has. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Kukës jepen në tabelën 25.

Nga të dhënat e Tabelës 25, referuar raportimeve të shoqërive pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 85.2 l/ditë për banorë, apo sipas faturimit aforfe që rezulton një konsum prej 99.4 l/ditë për banor, është larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor.

Këto tregues tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben si dhe asaj në juridiksion, me prioritet konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor ose të shpjegojë arsyet e këtij nënfaturimi.

Tabela 25. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. Kukës	Popullsia me shërbim	Konsumi total ne m ³	Konsumi i matur ne m ³	Konsumi i pamatur ne m ³	Nr. lidhjeve me mates	Nr.lidhjeve pa mates	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/dite, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
2024	48,968	1,546,000	843,401	791,819	6,289	5,060	85.2	99.4	86.5

Nga ana tjetër, referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale.

Për këtë qëllim në Tabelën 26, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen kapaciteti total i burimeve ujore të disponueshme për rajonin e kësaj shoqërie.

Tabela 26. Konsumi i faturuar për konsumatorët familjare dhe disponibiliteti i burimeve

Sh.R. Kukës	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Juridiksionit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
2024	48,968	3,540,456	86.5	89,467	33,664,016	+ 1030.9	+ 944.4

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga tabela 26, shihet se shoqëria rajonale UK Kukës ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit, (megjithëse nuk kemi një vlerësim të përditësuar të kapaciteteve të burimeve) gjithsesi në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja dhe shfrytëzimi me efikasitet i burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse, për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7”, për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Kukës

Shoqëria Rajonale UK Kukës, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Kukës, Tropojë dhe Has ofron shërbimin e furnizimit me ujë vetëm për **54.7%** të popullsisë totale nga 53.6 % që ka rezultuar ky tregues për vitin 2023 (referuar raportimit nga sektori i monitorimit). Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet **12,696 lidhje**, nga të cilat 7,412 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës dhe rezultojnë i pandryshuar krahasuar me vitin 2023.

Prodhimi vjetor **3,540,456 m³** rezultojnë i matur në nivelin **21.2% nga 17.6 %** në vitin 2023, por nevoja për aparate ujëmatës në pikat prodhuese është imediate për të gjitha burimet e shfrytëzueshme. Uji Pa të Ardhura rezultojnë në nivelin **43.47%** të ujit që hyn në sistem, nga **51.54%** në vitin 2023, shoqëria faturon vetëm **2,001,549 m³ ujë ose 56.53%** të prodhimit nga 48,46 % që ka rezultuar në vitin 2023.

Tabela 27, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Kukës.

Tabela 27. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Kukës – Viti 2024

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	3,540,456	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	955,483	26.99%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,046,067	29.55%
Faturimi total	2,001,549	56.53%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	68,468	1.93%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	80,000	2.26%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	60,000	1.69%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	560,439	15.83%
Humbjet e dukshme (administrative)	700,439	19.78%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	100,000	2.82%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	180,000	5.08%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	140,000	3.95%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	140,000	3.95%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	210,000	5.93%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	770,000	21.75%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	1,470,439	41.53%
UJI PA TË ARDHURA	1,538,907	43.47%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 27:

- Treguesi UPA në nivelin 43.47% nga 51.54 % në vitin 2023 të prodhimit vjetor, me trend zbritës, tregon një përmirësim të këtij indikator të rëndësishëm performance, duke kapërcyer nivelin e *performancës së dobët*, megjithëse nevojitet ende punë për përmirësimin e tij dhe arritjen e nivelit të performancës së mirë.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i prodhuar”, në nivelin 21.2% megjithëse në përmirësim krahasuar me vitet e kaluara i bën të pa besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit, duke filluar që nga vlera e pasaktësisë në matje prej 15.83% megjithëse ky parametër rezulton i përmirësuar pasi në vitin 2023 rezultonte 25.69 % të prodhimit vjetor.
- Ajo çfarë vihet re është përmirësimi i dukshëm i nivelit të humbjeve administrative në nivelin 19.78% në vitin 2024 nga 29.9% që rezultonte në vitin 2023, ku peshën më të madhe e zënë humbjet nga pasaktësitë në matje, që paraqitet i përmirësuar krahasuar me vitin 2023.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarjes 1.69% dhe të transmetimit 2.26%, (me trend përkeqësimi shumë të vogël krahasuar me vitin 2023) nuk mund të konsiderohen

të besueshme deri sa ato të verifikohen në terren nëpërmjet një ekipi të ngritur për këtë qëllim.

- Në humbjet teknike nga riparimet në linjat e ujësjellësit vlera prej 5.93% e prodhimit vjetor, megjithëse në trend zbritës krahasuar me vitin 2023 (kjo vlerë rezultonte 6.68 %) konsiderohet mjaft e lartë prandaj duhen dhënë argumenta të mëtijshme për justifikimin e tyre. Vihet re ulje e humbjeve nga rrjedhjet në linjat e transmetimit dhe shpërndarjes krahasuar me vitin 2023, por janë ende të larta. Raportohet i pandryshuar niveli i humbjeve nga rrjedhjet dhe derdhjet në depot e ujit krahasuar me vitin 2023.
- Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 58.4 % të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë ky tregues kërkohet të jetë sa me afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit për të gjitha njësitë, trajnimi i stafit mbi “humbjet e ujit” është i domosdoshëm.

Rekomandime:

- *Hartimi i saktë dhe real i Bilancit të Ujit së pari kërkon të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë.*
- *Të vlerësojë nevojat, dhe të shohë mundësinë për t’i pajisur me ujëmatësa të gjitha burimet e shfrytëzueshme prej saj, të përmirësojë përqindjen e konsumatorëve familjarë me matës, që ky tregues të jetë sa me afër nivelit 100%, me prioritet instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme.*
- *Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*

- *Task - Forca vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren për verifikime në vend për lidhjet e paligjshme, për anash kalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, të monitorojë punën e lexuesve të matësave dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e nën faturuar.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, lidhur me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej. Të saktësohen numri i popullsisë së shërbimit dhe i zonës së juridiksionit, sepse vihet re që nuk korrespondojnë me ato të publikuara nga INSTAT dhe kjo sjell një të analizë joreale të situatës lidhur me përdorimin e ujit.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo fillim viti.*

11. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë

Shoqëria Rajonale UK Lezhë, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Lezhë, Mirditë dhe Kurbin ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 55.63% të popullsisë në juridiksion sipas raportimit pranë sektorit të monitorimit.

Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Lezhë, jepen në tabelën 28.

Nga të dhënat e Tabelës 28, referuar raportimeve të shoqërive pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 56.4 l/ditë për banorë, është larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor.

Vlerat e konsumit të matur apo konsumit total, për banor në ditë, tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben dhe në juridiksion, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), po kështu dhe për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor, ndaj shoqëria të shpjegojë arsyet e këtij nën faturimi.

Tabela 28. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. Lezhë	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m ³	Konsumi i matur në m ³	Konsumi i pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/dite, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
2024	116,968	2,769,000	2,039,000	730,000	24,741	4,458	56.4	111.8	64.9

Nga ana tjetër referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 29, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektivë dhe kapacitetet e tyre.

Tabela 29. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. Lezhë	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
2024	116,968	8,062,000	64.9	211,947	25,383,740	+ 328.1	+ 263.2

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga Tabela 29, shihet qartë se shoqëria rajonale UK Lezhë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit, por vlen të theksohet se rezulton në nivele shumë të ulëta konsumi total dhe kjo sjell një vlerësim joreal të sasisë së disponueshme të ujit për banor në ditë, ndërkohë që edhe kapaciteti i burimeve është marrë i pandryshuar, ndaj shoqëria duhet të analizojë dhe të raportojë ecurinë e kapaciteteve të burimeve aktuale. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në kërkesën për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë

Shoqëria Rajonale UK Lezhë, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Lezhë, Mirditë dhe Kurbin ka nën juridiksion **211,947** banorë sipas të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë për vitin 2024 është **31,848** lidhje, nga të cilat **27,217** lidhje janë të pajisur me ujëmatës. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për **116,968** banorë ose **55.2 %** të popullsisë totale.

Prodhimi vjetor prej 8,062,000 m³ rezulton i matur në nivelin **61.3% nga 29.1%** që ishte raportuar në vitin 2023, kjo si rezultat i investimeve për Ujëmatëse në pikat prodhuese (burime), kryesisht për njësitë Mirditë dhe Kurbin.

Uji Pa të Ardhura rezulton në nivelin 58.63% të ujit që hyn në sistem nga **70.71% raportuar në vitin 2023**, faturimi total u realizua për **41.37 %** të prodhimit nga **29.18 %** raportuar në vitin 2023.

Tabela 30 paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Lezhë.

Tabela 30. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë – Viti 2024

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	8,062,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,521,060	31.27%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	814,140	10.10%
Faturimi total	3,335,200	41.37%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	6,689	0.08%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit		0.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës		0.00%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	3,306	0.04%
Humbjet e dukshme (administrative)	3,306	0.04%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	76,350	0.95%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	3,307	0.04%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	3,306	0.04%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	4,599,138	57.05%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	34,704	0.43%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	4,716,805	58.51%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	4,720,111	58.55%
UJI PA TË ARDHURA	4,726,800	58.63%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 30:

- Treguesi UPA në nivelin 58.63% të prodhimit vjetor nga 70.82 % në vitin 2023 duke reflektuar kështu një përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi të rëndësishëm por që është ende larg nivelit të performancës së mirë dhe që duhet përmirësuar.
- Niveli i matjes 63.1 % për faktorin “Uji i prodhuar”, ka një ndryshim shumë cilësor krahasuar me vitin 2023 që rezultonte 29.1%, dhe kjo shoqërohet dhe me nivele shumë të vogla të humbjeve që nuk e kalojnë nivelin e 0.5 %. Për këtë shoqëria duhet të japë sqarime dhe shpjegimet e nevojshme nëse këto parametra vijnë si rezultat i investimeve, matjeve reale dhe kontrolleve e menaxhimit më të mirë, apo si saktësim i vlerave.

- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes të zeruara nuk konsiderohen të besueshme dhe duhet të verifikohen në terren nëpërmjet strukturave të ngritura për këtë qëllim.
- Peshën pothuaj të 90% të humbjeve e zënë Humbjet nga rrjedhjet në linjat e shpërndarjes, në nivelin 57.05% që rezultojnë në zbritje krahasuar me vitin 2023 që rezultonte në nivelin 68.7 % të prodhimit vjetor. Megjithatë konsiderohen të lartë dhe duhen dhënë argumenta të mëtijshme për justifikimin e tyre.
- Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 77.6 % të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa me afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) për të gjithë zonën e shërbimit njësitë Mirditë dhe Kurbin.

Referuar të dhënave të shoqërisë dhe Planit të Biznesit të saj, për të rritur nivelin e matjes gjatë periudhës 2024-2025, janë ndërmarrë masa si më poshtë:

- Instalimi i matësave të rinj tek klientët familjare pa matës rreth 1290 matës .
- Zëvendësimi i matësave të amortizuar (matësat e prishur) me matësa të rinj rreth 200.
- Pajisja e abonentëve aforfe me matës.

Kjo reflektohet në përmirësimin e treguesit “Uji pa të ardhura” duke zbritur nga niveli 70.82% në vitin 2023 në 58.63%. Pra nga analiza e bilancit të ujit vihet re se në këtë shoqëri rajonale komponenti pothuaj i vetëm i humbjeve janë humbjet nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës, që mund të vij nga rrjetet e amortizuara në zonat kryesisht jo urbane duke nxjerrë në pah dhe nevojën për investime. Ajo që është më e evidente janë pothuaj zerimi i humbjeve administrative dhe këtu duhet të kihet në vëmendje dhe saktësia e të dhënave të raportuara.

Rekomandime:

- *Të insistohet për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*

- *Të trajnoje vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa me afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe është e nevojshme një analizë e besueshme dhe e vërtete e humbjeve të dukshme, pavarësisht së ato raportohen në disa raste mjaft të ulëta.*
- *Shoqëria duhet të punojë në hartimin e një harte të rrjetit me GIS dhe të identifikojë zonat e vjetra, ato me presion të lartë, pra zonat problematike dhe emergjente për ndërhyrje.*
- *Task - Forca vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anash kalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësave dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e faturuar.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohet.*
- *Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banoreve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992. Të saktësohen numri i popullsisë së shërbimit dhe i zonës së juridiksionit, sepse vihet re që nuk korrespondojnë me ato të publikuara nga INSTAT dhe kjo sjell një të analizë joreale të situatës lidhur me përdorimin e ujit*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohe pranë ERRU-së çdo fillim viti.*

12. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Lushnje

Shoqëria rajonale UK Lushnje është formuar nga bashkimi i shoqërive UK Lushnje dhe UK Divjakë. Kjo shoqëri ofron shërbimin e furnizimit me ujë për **106,532 banorë ose për 56.5 %** të popullsisë në juridiksionin e saj (referuar raportimit pranë sektorit të monitorimit). Nga raportimi i kësaj shoqërie rezulton se për vitin 2024 i gjithë uji i prodhuar në masën 5,586,000 m³ është i matur 100% (sasia

prej 869,000 m³ blihet me shumicë) dhe prodhohet totalisht nga sisteme me ngritje mekanike. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Lushnje jepen në tabelën 31.

Konstatohet probleme me faturimin aforfe pasi rezulton se sasia prej 206 l/ditë, banorë është shumë më lartë referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 që duhet të jetë 150 litra/banor në ditë, ndaj shoqëria rajonale Lushnje duhet të analizojë arsyet e mbi faturimit aforfe (nëse përfshijnë në të dhe klientët jo aktive). Gjithashtu dhe konsumi i matur prej 66.9 l/ditë për banorë është më e ulët se norma prej 150 l/ditë për banorë dhe duhet të ketë shpjegim nga ana e shoqërisë, për shkaqet që sjellin këto tregues.

Tabela 31. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. Lushnje	Popullsia e shërbyer	Konsumi total ne m ³	Konsumi i matur ne m ³	Konsumi i pamatur ne m ³	Nr. Lidhjeve me mates	Nr.lidhjeve pa mates	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
2024	106,532	2,609,000	2,600,000	9,000	26,665	30	66.9	206.0	67.1

Nga ana tjetër referuar tendencës se rritjes se vazhdueshme te kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën 32, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre të cilat i kemi konsideruar të njëjta me vitet e mëparshme pasi ende nga shoqëria nuk ka një analizë faktike të tyre.

Tabela 32. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Lushnje	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
2024	106,532	6,455,420	67.1	188,296	13,087,440	+ 190.4	+ 123.3

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga Tabela 32, shihet se shoqëria rajonale UK Lushnje ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit, por nga analiza rezulton në nivele shumë të ulëta konsumi total për banor në ditë dhe kjo sjell një vlerësim joreal të sasisë së disponueshme të ujit, ndërkohë që edhe kapaciteti i burimeve është marrë i pandryshuar. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë

në 24/7” për çdo njësi furnizimi, kur aktualisht kjo shoqëri raporton një kohëzgjatje të furnizimit me ujë mesatarisht prej 17 orë.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Lushnje

Shoqëria Rajonale UK Lushnje, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Lushnje dhe Divjakë, ka në juridiksion 188,296 banorë. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet për 106,523 banorë ose 56.6% të popullsisë totale. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 28 687 lidhje, nga të cilat 28 634 ose 99,8 % lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor 6,455,420 m³ raportohet i matur në nivelin 100 %. Uji Pa të Ardhura është në nivelin 54.13% nga 57.04 % (ne vitin 2023) të ujit që hyn në sistem dhe shoqëria faturon 2,961,360 m³ ujë ose 45.87% nga 42.96 % (në vitin 2023) të prodhimit.

Tabela 33, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Lushnje.

Tabela 33. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Lushnje – Viti 2024

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	6,455,420	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,939,735	45.54%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	21,625	0.33%
Faturimi total	2,961,360	45.87%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	52,396	0.81%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	579,847	8.98%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	702,103	10.88%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	167,666	2.60%
Humbjet e dukshme (administrative)	1,449,616	22.46%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	558,879	8.66%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	34,931	0.54%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	69,861	1.08%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	697,628	10.81%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetësit	630,749	9.77%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,992,048	30.86%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	3,441,664	53.31%
UJI PA TË ARDHURA	3,494,060	54.13%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 33:

- Treguesi UPA në nivelin 54.13% nga 57.04% të prodhimit vjetor në vitin 20223, megjithëse në trend zbritës konsiderohet në nivel të papranueshëm dhe shoqëria rajonale duhet të marri masa për përmirësimin e saj.

- Niveli i matjes për faktorin “Uji i prodhuar”, në nivelin 100% është një tregues pozitiv për këtë shoqëri.
- Konsumi total i faturuar është në nivelin 45.87% nga 42.96 % në vitin 2023, vetëm 0.81% është konsum i faturuar i pamatur paraqitet në nivel të pandryshuar referuar viti 2023.
- Niveli i humbjeve reale është 30.86 % nga 31.44 % në vitin 2023 e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, duke rezultuar me një trend pozitiv/zbritës. Peshën më të madhe e zënë humbjet nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës që mbetet pothuaj i pandryshuar në nivelin 10.81%, nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit 8.66% që rezultojnë në rënie nga viti 2023 që ishin në nivelin 12.22 %, por që konsiderohen ende të larta.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 22.46% nga 24.85% në vitin 2023, e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen, si rezultat i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 19.86% nga 16.24% në vitin 2023 të prodhimit vjetor, duke treguar një rritje përkeqësim të këtyre zërave, ndërsa humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin 2.06% nga 8.61% në vitin 2023 pasqyrojnë një përmirësim të ndjeshëm.
- Numri i klientëve me ujëmatës rezulton 28 687 lidhje, nga të cilat 28 634 ose 99,8 % lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës, por ky tregues rezulton me rënie krahasuar me vitin 2023 ku paraqiteshin në vlerat 29,931 klientë dhe 99.2% të totalit të klientëve e merrnin këtë shërbim, ndaj dhe duhet një shpjegim nga ana e shoqërisë për këtë tregues në mënyrë që të ketë një vlerësim më real të menaxhimit të kërkesës për ujë.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit

Rekomandime:

- *Shoqëria nga ana e saj duhet të punojë për hartëzimin e rrjetit ekzistues dhe të identifikojë zona të përshtatshme për t'u ndarë në DMA (duke konsideruar presionin, dendësinë e popullsisë, tipin e rrjetit) dhe të bëjë përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme të tilla në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë. Kjo do t'i mundësojë një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*

- *Trendi rritës dmth përkeqësues i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në nivelin 19.86% krahasuar me vitin 2023 që ishin në vlerën 16.24%, kërkon nga shoqëria ndërmarrjen e një plan veprimi për të përcaktuar saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHEE-së pasi konsiderohet i lartë dhe duhet minimizuar drejt eliminimit total.*
- *Task-Forca vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë për verifikime në vend për të thelluar analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika tek matësat duke kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësave, lidhjet e paligjshme etj.*
- *Humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit dhe atë shpërndarës të cilat janë në nivelin 19.4% nga 22.79 % në vitin 2023, kërkojnë një analizë të detajuar të gjendjes teknike të rrjetit, si dhe të bëhen përpjekje për gjendjen e fondeve nga qeveria qendrore ose të planifikohen fonde nga shoqëria rajonale për rehabilitimin ose zëvendësimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktim akoma më të ndjeshëm të ujit pa të ardhura.*
- *Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara. për hartimin e bilancit të ujit. Të saktësohen numri i popullsisë së shërbimit dhe i zonës së juridiksionit, sepse vihet re që nuk korrespondojnë me ato të publikuara nga INSTAT dhe kjo sjell një të analizë joreale të situatës lidhur me përdorimin e ujit.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së, çdo fillim viti.*

13. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Pogradec

Shoqëria Rajonale UK Pogradec, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Pogradec (Qytetin Pogradec dhe 7 Njësitë Administrative Buçimas, Hudënisht, Çërravë, Dardhas, Proptisht, Velçan, Trebinjë) dhe njësinë administrative Përrenjas (territorin e Bashkisë Përrenjas me gjithë fshatrat e saj), e cila ka qenë zonë shërbimi e ish shoqërisë rajonale UK Librazhd, ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 89 % të popullsisë në juridiksion. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh. R UK Pogradec jepen në tabelën 34.

Nga të dhënat e Tabelës 34, referuar të dhënave të shoqërisë, të raportuara pranë sektorit të monitorimit, për numrin e popullsisë me shërbim dhe atë të regjistruar në juridiksion rezulton se, konsumi i matur, apo dhe faturimi aforfe (nëse përfshijnë në të dhe klientët jo aktive), të jenë në shifra jo të arsyeshme sepse dihet që konsumi mesatar për banorë për këtë lloj faturimi referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë 150 litra/ditë për banorë.

Tabela 34. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare më Matje dhe Aforfe

Sh.R. Pogradec	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m3	Konsumi i matur në m3	Konsumi i pamatur në m3	Nr. Lidhjeve me matës	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/dite, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2024	104,036	2,148,000	2,098,000	50,000	24,473	931	57.4	35.9	56.6

Referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 35, krahas volumnit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre të cilat edhe për këtë vit do të merren të pandryshuara. Nga ana e shoqërisë kërkohet marrja e masave konkrete për vlerësimin real të burimeve që shfrytëzojnë nën ndikimin e ndryshimeve klimaterike.

Tabela 35. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. Pogradec	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(l/ditë, banor)		(në m3/vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2024	104,036	3,644,260	56.6	116,853	12,922,960	+ 303.0	+ 246.4

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga tabela 35, shihet se, shoqëria rajonale UK Pogradec ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit, por vlen të theksohet se rezulton në nivele shumë të ulëta konsumi total dhe kjo sjell një vlerësim joreal të sasisë së disponueshme të ujit për banor në ditë, ndërkohë që edhe kapaciteti i burimeve është marrë i pandryshuar. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshëm, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitet përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit më ujë më 24/7” për çdo njësi furnizimi.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Pogradec

Shoqëria Rajonale UK Pogradec, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Pogradec dhe Përrenjas ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 89 % të popullsisë në juridiksion referuar raportimit në sektorin e monitorimit. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 27 136 lidhje, nga të cilat 26 170 ose 96.4% janë të pajisur me aparate ujëmatës nga 93.9 % që rezultonte në vitin 2023.

Shoqëria rajonale UK Pogradec ka prodhuar 3,644,260 m³ ujë gjatë vitit 2024, i cili raportohet i matur në nivelin 70% nga 69.6% që është raportuar në vitin 2023. Mbetet e domosdoshme nevoja për aparate ujëmatës në pikat prodhuese për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

Uji Pa të Ardhura është në nivelin 34.36% të ujit që hyn në sistem, pothuaj i pandryshuar krahasuar me vitin 2023, dhe shoqëria faturon vetëm 2,391,940 m³ ujë ose 65.64 % të prodhimit.

Në tabelën 36, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Pogradec.

Tabela 36. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Pogradec – Viti 2024

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	3,644,260	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,341,174	64.24%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	50,766	1.39%
Faturimi total	2,391,940	65.64%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	33,470	0.92%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	49,258	1.35%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	53,689	1.47%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	77,760	2.13%
Humbjet e dukshme (administrative)	180,707	4.96%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	222,150	6.10%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	47,524	1.30%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	44,125	1.21%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	702,540	19.28%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	21,807	0.60%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,038,146	28.49%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	1,218,853	33.45%
UJI PA TË ARDHURA	1,252,323	34.36%

Komente mbi të dhënat e tabelës 36 :

- Treguesi UPA në nivelin 34.36% të prodhimit vjetor, rezulton të jete në pothuaj të njëjtin nivel me vitin 2023, megjithëse nën mesataren e sektorit për të gjithë vendin konsiderohet në nivele jo të kënaqshme dhe që kërkon angazhim të mëtejshëm për t'u përmirësuar.
- “Uji i Prodhuar” matet në nivelin 79% nga 65.18% i raportuar për vitin 2023, prandaj shoqërisë i nevojiten hapa të mëtejshëm për gjetjen fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e ujë matësive në të gjithë burimet e furnizimit me ujë, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin transmetimit 1.35% dhe në rrjetin shpërndarës 1.47% pasqyrojnë një mirëmenaxhim dhe punë serioze të bërë nga shoqëria rajonale në uljen e këtyre humbjeve krahasuar me vitin 2023, të cilat ishin në nivelet 3.12 % dhe 4.16%.
- Humbjet nga rrjedhjet në linjat e transmetimit në nivelin 6.10 % të prodhimit vjetor nga (3.91% në vitin 2023) dhe të shpërndarjes në nivelin 19.28% nga (18.02% në vitin 2023) tregojnë një trend rritës të këtyre humbjeve ndaj duhet të verifikohen në terren dhe të jepen argumente të mëtejshme për justifikimin e tyre.
- Konsumatorët me matje përbëjnë rreth 96.4 % të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa më afër nivelit 100 % të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo sipas zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.

Nga analiza e bërë rezulton se Sh.R UK Pogradec e ka ulur nivelin e humbjeve administrative por vihet re një rritje e nivelit të humbjeve reale, dhe duke mbajtur pothuaj në të njëjtat nivele Humbjet totale si dhe Ujin pa të Ardhura krahasuar me vitin 2023.

Rekomandime:

- *Duhet të ndërmerren masa konkrete dhe të menjëhershme për projektimin dhe zbatimin e sistemeve DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë për të mundësuar monitorimin, diagnostikimin dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*

- *Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e ujëmatësve në çdo burim si domosdoshmëri për hartimin e një bilanc uji sa më real.*
- *Shoqëria duhet të bëjë një analizë të thelluar në terren për të gjetur shkaqet e vërteta të rrjedhjeve në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, si faktor i rëndësishëm për uljen e humbjeve reale (teknike).*
- *Të konsiderojë si nevojë të vazhdueshme trajnimin e stafit teknik në programet kombëtare apo ndërkombëtare, mbi trajtimin e humbjeve të ujit, duke i dhënë përparësi personave përgjegjës të përcaktuar nga shoqëria për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave që raportohen, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Shoqëria të planifikojë dhe të sigurojë fonde për të rritur përqindjen e të gjithë kategorive të konsumatorëve me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, të cilat ndonëse në disa raste raportohen në nivele mjaft të ultë janë të pa besueshme.*
- *Hartimi i një plan veprimi më prioritet instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Task Forca efektive e pajisur me të gjithë logjistikën e duhur, të verifikojë dhe evidentojë vazhdimisht në terren, lidhjet e paligjshme në të gjithë sistemin e furnizimit me ujë, për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, të kontrollojë punën e lexuesve të matësve dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e nën faturuar.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të pasur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej. Të saktësohen numri i popullsisë së shërbimit dhe i zonës së juridiksionit, sepse vihet re që nuk korrespondojnë me ato të publikuara nga INSTAT dhe kjo sjell një të analizë joreale të situatës lidhur me përdorimin e ujit.*
- *Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*

- Të forcojë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së çdo fillim viti.

14. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë

Shoqëria rajonale UK Sarandë përbëhet nga ish shoqëritë UK ose Njësitë, përkatësisht UK Sarandë, UK Finiq, UK Delvinë dhe UK Konispol.

Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh R UK Sarandë jepen në tabelën 37.

Nga të dhënat e Tabelës 38, referuar raportimeve të shoqërive pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 63 l/ditë për banorë, apo sipas faturimit aforfe që rezulton një konsum prej 50.9 l/ditë për banor, është larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor.

Këto vlera tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben dhe në juridiksion, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor, ose të shpjegojë arsyet e këtij nën faturimi.

Tabela 37. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. Sarandë	Popullsia me shërbim	konsumi total ne m3	Konsumi I matur ne m3	Konsumi I pamatur ne m3	Nr. lidhjeve me mates	Nr.lidhjeve pa mates	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/dite, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
2024	100,080	2,277,990	2,174,590	103,400	25,959	1,529	63.0	50.9	62.4

Referuar tendencës në rritje të vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve demografike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën 38, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre. Edhe për 2024 kemi mbajtur të njëjtën parametër të kapaciteteve të burimeve për ujë të pijshëm, pasi nuk ka një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela 38. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. Sarandë	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
2024	100,080	7,125,060	62.4	125,529	27,097,648	+ 591.4	+ 529.0

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga tabela 38, shihet se shoqëria rajonale UK Sarandë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë

Shoqëria Rajonale UK Sarandë, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë, ka nën juridiksion 125,529 banorë. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 100,080 ose 79.73% të popullsisë totale. Numri i lidhjeve totale për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 32,147 lidhje, nga të cilat 30,594 lidhje ose 95.17 % janë të pajisur me aparate ujëmatës nga 93.3% që rezultonte në vitin 2023.

Prodhimi vjetor 7,125,060 m³ rezulton i matur në nivelin 78.6 %. Nevoja për aparateve ujëmatës në pikat prodhuese ku ato mungojnë është imediate.

Uji Pa të Ardhura rezulton në nivelin 57.59 % të ujit që hyn në sistem, shoqëria faturon vetëm 3,021,630 m³ ujë ose 42.41 % të prodhimit.

Tabela 39, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Sarandë.

Tabela 39. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë – Viti 2024

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	7,125,060	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,918,183	40.96%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	103,447	1.45%
Faturimi total	3,021,630	42.41%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	71,307	1.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	142,615	2.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	713,078	10.01%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	184,666	2.59%
Humbjet e dukshme (administrative)	1,040,359	14.60%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	285,231	4.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	128,354	1.80%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	156,877	2.20%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	1,351,685	18.97%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	1,069,617	15.01%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	2,991,764	41.99%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	4,032,123	56.59%
UJI PA TË ARDHURA	4,103,430	57.59%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 39:

- Treguesi UPA në nivelin 57.59 % të prodhimit vjetor nga 73.17 % në vitin 2023, megjithëse me një përmirësim të konsiderueshëm nga viti 2023 me 15.58 % sërish konsiderohet shumë i lartë dhe që duhet përmirësuar.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i prodhuar”, në nivelin 78.6 % është i pranueshëm, por nevojitet të vendosen aparateve ujëmatës në të gjitha pikat prodhuese ose burimet e shfrytëzueshme.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarje prej 10.01 nga 7.58% në vitin 2023 janë të larta dhe në përqendrim me 2.43 % për këtë vit.
- Humbjet teknike rezultojnë në nivelin 41.99 % me një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2023 që ishin 45.34 %. Peshën më të madhe në humbjet teknike e zënë humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes në nivelin 18.97 % dhe humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës në nivelin 15.01 %. Këto humbje konsiderohet mjaft të larta prandaj, duhen dhënë argumenta të mtejshme për justifikimin e tyre.

- Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 80.75 % të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa më afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit për çdo njësi të shoqërisë rajonale, nevoja për trajnim të stafit është e domosdoshme.

Rekomandime:

- *Niveli i matjes së ujit të prodhuar është 78.6 %. Duke patur parasysh që disa prej burimeve të furnizimit me ujë nuk janë të pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa me real.*
- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, pavarësisht se ato për disa njësi raportohen në disa raste mjaft të ultë dhe të pabesueshme.*
- *Hartimi i një plan veprimi me prioritet instalimin e matësave në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*

- Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarjes, shoqëria duhet të ndërmarë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHE-se.
- Të ngrihet një Task Forcë e cila vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësive dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e nën faturuar.
- Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej.
- Për korrigjimin e normave të faturimit me matje, shoqëria duhet të angazhohet në gjetjen e lidhjeve dyfishe. Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.
- Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikës në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë.
- Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo fillim viti për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë. Të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.

15. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër

Shoqëria Rajonale UK Shkodër, është krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Shkodër, Fushë Arrëz, Pukë, Vau i Dejës dhe Malësia e Madhe. Shërbimin i FU i ofrohet **175,939 banorëve ose 52.5%** të popullsisë në juridiksion, sipas të dhënave të raportuar nga shoqëria pranë sektorit të monitorimit. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Shkodër jepen në tabelën 40.

Nga të dhënat e Tabelës 40, vërehet se shoqëria rajonale Shkodër ka probleme në faturimin aforfe. Faturimi me matje është 53.2 l/ditë/banor por duke pasur parasysh normën mesatare, tashmë të pranueshme për të gjithë sektorin, prej 100 l/ditë për banorë kjo vlerë është nën normën e lejuar,

gjithashtu faturimi aforfe është nën normën prej 150 l/ditë për banorë. Këto vlera tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben dhe në juridiksion, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor, ose të shpjegojë arsyet e këtij nën faturimi.

Tabela 40. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfes

Sh.R. Shkoder	Popullsia me sherbim	Konsumi total në m ³	Konsumi i matur në m ³	Konsumi i pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me mates	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2024	175,939	4,268,000	2,579,000	1,689,000	31,526	10,255	53.2	107.2	66.5

Nga ana tjetër referuar tendencës në rritje të vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 41, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe kapaciteti i burimeve ujore që shfrytëzon kjo shoqëri për furnizimin me ujë të popullatës, por vlen të citojmë që edhe për vitin 2024 kemi marr të njëjtën vlerë duke qenë se nuk kemi të dhëna të përditësuara të këtij faktori.

Tabela 41. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. Shkodër	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(l/ditë, banor)		(në m3/vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2024	175,939	14,213,090	66.5	334,968	49,927,854	+ 408.4	+ 341.9

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga Tabela 41, shihet se shoqëria rajonale UK Shkodër ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë, për popullsinë totale të regjistruar në zonën e saj të shërbimit sipas të dhënave të raportuara nga vet shoqëria, pasi rezulton se ka një sasi të disponueshme prej 408.4l/ditë për banor, kur konsumi total i matur dhe aforfe është 66.5 l/ditë,banor. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të tyre, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë megjithëse gjatë 2024 vihet re ulje e sasisë së prodhimit të ujit që futet në sistemet e kësaj shoqërie rajonale, si dhe reduktimin e humbjeve të ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër

Shoqëria Rajonale UK Shkodër, është krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Shkodër, Fushë Arrëz, Pukë, Vau i Dejës dhe Malësia e Madhe. Kjo shoqëri ka në juridiksion **334,968 banorë sipas raportimit pranë sektorit të monitorimit**. Shërbimin i FU i ofrohet **175,939 banorëve ose 52.5%** të popullsisë totale. Vihet re një rritje e popullsisë së shërbyer, pavarësisht saktësimit të numrit të popullsisë totale në juridiksion krahasuar me vitin 2023. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 46,436 lidhje nga **45,087 lidhje në vitin 2023**, nga të cilat 35,753 ose 76.9% janë të pajisur me matësa uji nga **74.9%** që rezultonte në 2023.

Prodhimi vjetor, në masën 14,123,090 m³ (**584,110 m³ më pak se viti 2023**) **vazhdon të mbetet 100% i vlerësuar**, pra mungojnë matësat në të gjithë burimet.

UPA është në nivelin 64% nga **67.01% në vitin 2023** të ujit që hyn në sistem, vazhdon të ruaj trendin e përmirësimit që prej vitit 2022. Shoqëria faturon vetëm **5,116,211 m3 ujë ose 36% të ujit që prodhon nga 32.98 % në vitin 2023**.

Tabela 42, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Shkodër.

Tabela 42. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër – Viti 2024

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	14,213,090	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	3,334,431	23.46%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,781,780	12.54%
Faturimi total	5,116,211	36.00%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	69,828	0.49%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	226,569	1.59%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	7,706,154	54.22%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	144,298	1.02%
Humbjet e dukshme (administrative)	8,077,021	56.83%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	259,165	1.82%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	106,255	0.75%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	250,896	1.77%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	228,452	1.61%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	105,253	0.74%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	950,021	6.68%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	9,027,042	63.51%
UJI PA TË ARDHURA	9,096,870	64.00%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 42:

- Treguesi UPA në nivelin 64% nga 67.01% të prodhimit vjetor, megjithëse në trend zbritës referuar tre viteve të fundit konsiderohet mjaft e lartë dhe që duhet përmirësuar.
- “Uji i prodhuar që futet në sistem” totalisht i vlerësuar bën jo të besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit.
- Konsumi total i faturuar është në nivelin 36% nga 32.99% në vitin 2023, prej të cilit konsum i faturuar i pamatur mbetet i pothuajse i pandryshuar, në nivelet mbi 12.5%.
- Numri i klientëve me matës prej 76.9% të totalit të klientëve konsiderohet i papranueshëm pasi për një menaxhim korrekt të “Kërkesës për Ujë”, ky parametër duhet të jetë sa më afër 100%.
- Numri i Klientëve familjar me matës është 31,526 klientë ose 88.1 % e totalit të klientëve me matës.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 56.83% nga 58.52 % në vitin 2023, ku humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës në nivelin 54.22% zënë rreth 95% të këtyre humbjeve.
- Niveli i humbjeve reale në nivelin 6.68% vazhdon trendin zbritës nga viti 2023 ku raportoheshin 7.54 %.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi nga stafi i shoqërisë për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.

Nga analizimi i humbjeve të ujit në sistem, rezulton se humbjet administrative vazhdojnë të jenë të larta dhe zënë rreth 90% të totalit të humbjeve, ku humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës zënë rreth 54%, duke evidentuar kështu nevojën emergjente për kontrollin dhe monitorimin më efikas të rrjetit shpërndarës në gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.

Rekomandime:

- *Fakti që e gjithë sasia e ujit të prodhuar vlerësohet, evidenton nevojën e menjëhershme për investime në ujëmatësia në prodhim, ndaj shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre. Mungesa e tyre vë në dyshim vërtetësinë e vlerës së volumit të ujit të prodhuar dhe të vlerave të të gjithë komponenteve të Bilancit të ujit.*
- *Shoqëria duhet të marrë hapa konkrete për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë, për të mundësuar monitorimin, evidentimin dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Shoqëria duhet të rrisë përqindjen e konsumatorëve familjare me matës, pasi ky tregues vazhdon të mbetet në nivelet 88%, dhe prioritet të kenë instalimi i matësive në shtëpitë private, kryesisht në zonat rurale për një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, sipas një plani veprimi të hartuar nga shoqëria.*
- *Niveli i lartë i lidhjeve të paligjshme me 54.22 %, kërkon nga shoqëria hartimin dhe zbatimin e një plani konkret veprimi për të përcaktuar sa më saktë bazën e klientëve dhe në bashkëpunim me Taks -Forcën e ngritur me mbështetjen e njësisë respektive të qeverisjes vendore, të jetë në veprim në terren, me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të parregjistruar me kontratë me shoqërinë, të kontrollojë punën e lexuesve të matësive dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e nën faturuar.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të pasur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej.*
- *Të saktësohen numri i popullsisë së shërbimit dhe i zonës së juridiksionit, sepse vihet re që nuk korrespondojnë me ato të publikuara nga INSTAT dhe kjo sjell një të analizë joreale të situatës lidhur me përdorimin e ujit.*
- *Të trajtojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, me prioritet personat përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*

- Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së sipas afateve kohore të kërkuara.

16. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Vlorë

Shoqëria rajonale UK Vlorë përbëhet nga ish shoqëritë UK ose Njësitë, përkatësisht UK Vlorë, UK Himarë dhe UK Selenicë.

Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Vlorë jepen në tabelën 43.

Nga të dhënat e Tabelës 43, referuar raportimeve të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion vërehet se, shoqëria rajonale Vlorë ka probleme me i përket faturimit aforfe shoqëria (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktive), sepse dihet që konsumi mesatar për banor për këtë lloj faturimi referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 duhet të jetë 150 litra/ditë, banorë.

Tabela 43. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Vlorë	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m ³	Konsumi I matur në m ³	Konsumi I pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me mates	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							I/dite, banor	I/ditë, banor	I/ditë, banor
Viti 2024	216,567	5,477,000	3,113,000	2,364,000	47,454	17,454	53.9	111.2	69.3

Nga ana tjetër referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 44, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre.

Tabela 44. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Vlorë	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(I/ditë, banor)		(në m3/vit)	(I/ditë, banor)	(I/ditë, banor)
Viti 2024	216,567	26,643,400	69.3	250,294	46,687,326	+ 511.0	+ 441.7

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga Tabela 44, shihet se shoqëria rajonale UK Vlorë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit, referuar të dhënave të shoqërisë, të raportuara pranë sektorit të monitorimit, për numrin e popullsisë me shërbim dhe atë të regjistruar në juridiksion. Kështu rezulton se, konsumi i matur, apo dhe faturimi aforfe (nuk është e qartë nëse përfshijnë në të dhe klientët jo aktive), të jenë në shifra jo të arsyeshme sepse dihet që konsumi mesatar për banorë për këtë lloj faturimi referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë 150 litra/ditë për banorë.

Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të tyre, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve të ujit në të gjitha njësitet përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Vlorë

Shoqëria Rajonale UK Vlorë, është krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Vlorë , Himarë dhe Selenicë. Kjo shoqëri ka në juridiksion 250,294 **banorë**. Shërbimin e furnizimit me ujë e marrin **216,567 banorë** ose **86.5%** të popullsisë totale. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet **72,623** lidhje, nga të cilat **53,566 lidhje** ose **73.7 %** janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor **26,643,400 m³** (rreth 173,400 m³ më shumë se viti 2023) vazhdon të raportohet i vlerësuar në nivelin **100%**, duke evidentuar se nevoja për ujëmatës në pikat prodhuese është imediate për të gjitha burimet e shfrytëzueshme. **Uji Pa të Ardhura** është në nivelin 73.55% nga **79.41% në vitin 2023** të ujit që hyn në sistem dhe shoqëria faturon vetëm **7,047,000 m³** ujë ose 26.45% të prodhimit nga **20.59% që raportohet në vitin 2023**.

Tabela 45, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Vlorë.

Tabela 45. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Vlorë – Viti 2024

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	26,643,400	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	4,442,000	16.67%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	2,605,000	9.78%
Faturimi total	7,047,000	26.45%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	57,000	0.21%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	2,370,400	8.90%

Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	6,548,295	24.58%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	2,542,000	9.54%
Humbjet e dukshme (administrative)	11,460,695	43.02%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	4,025,999	15.11%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	633,221	2.38%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	80,000	0.30%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	2,684,514	10.08%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	654,871	2.46%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	8,078,605	30.32%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	19,539,300	73.34%
UJI PA TË ARDHURA	19,596,300	73.55%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 45:

- Treguesi UPA në nivelin 73.55% të prodhimit vjetor megjithëse pasqyron një përmirësim shumë modest krahasuar me vitin 2023 që ka qënë në nivelin prej 79.41%, është më e lartë se mesatarja e sektorit për të gjithë vendin, duke u konsideruar e papranueshme dhe që padiskutim që duhet përmirësuar.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i prodhuar”, i cili vazhdon të mbetet në nivelin 0% është i papranueshëm, duke treguar se përpjekjet nga ana e shoqërisë për instalimin e matësve në prodhim vazhdojnë të mungojnë. Raportimi i prodhimit të ujit bazuar në vlerësime nga ana e shoqërisë i bën të pa besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit.
- Konsumi total i faturuar është në nivelin 26.45% nga 20.59% në vitin 2023, prej të cilit 16.67% është konsum i faturuar i matur.
- Numri i Klientëve familjar me matës ka rritje krahasuar me 2023 që ishte 37,714 klientë dhe në vitin 2024 raportohet 47,454 ose 72.5% e totalit të klientëve familjar nga 70.2% në 2023.
- Niveli i humbjeve reale është 30.32% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, ku kryesisht peshën më të madhe vazhdojnë ta zënë humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit në nivelin 15.11%, rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 10.08% (të dy këto tregues janë pothuaj në të njëjtin nivel si në vitin 2023), ndërsa humbjet për shkak të riparimeve 2.46%. Duhet theksuar se humbjet nga rrjedhjet në të gjithë sistemin vazhdojnë të mbeten të larta në nivelin 25.34% dhe vetëm humbjet nga rrjedhjet në depo rezultojnë me ulje nga viti 2023 nga 5.84% në 0.30% në vitin 2024.

- Niveli i humbjeve të dukshme është 43.02 % e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen, si rezultat i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 33.47% të prodhimit vjetor dhe humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin 9.54%.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.

Nga analiza e bërë vlen të theksohet se kjo shoqëri vazhdon të ruajë pothuaj të pandryshuar humbjet që vijnë si nga lidhjet e paligjshme ashtu dhe rrjedhjet, si në rrjetin e transmetit ashtu dhe në atë të shpërndarjes. Kjo shoqëri nga raportimi rezulton se ka një përmirësim të nivelit të faturimit krahasuar me vitin 2023.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që e gjithë sasia e ujit të prodhuar matet mbi bazë metodash vlerësuese dhe jo të matura me matës në prodhim, pasaktësia gjatë përlllogaritjes të kësaj vlere vë në dyshim dhe mungesë të besueshmërisë të vlerës së ujit të prodhuar dhe të të gjithë komponentëve të tjerë të Bilancit të ujit të llogaritur sipas metodës lart-poshtë.*
- *Nevoja emergjente për pajisjen me ujëmatës në prodhim kërkon nga shoqëria marrjen e masave urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Shoqëria duhet të marrë hapa konkrete për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë, për të mundësuar monitorimin, evidentimin dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjarë me matës (me prioritete instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale), pasi 17,952 klientë familjar janë pa matës, që përbëjnë 27.4% të totalit të klientëve familjarë, nga 26.8% që ka rezultuar ky tregues në vitin 2023 për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme. Shoqëria duhet të synojë dhe të punojë që ky tregues patjetër që duhet të jetë sa më afër nivelit 100%.*

- Humbjet reale në nivelin 30.42% që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit dhe në rrjetin shpërndarës në pothuaj të njëjtin nivel si në vitin 2023 kërkojnë që shoqëria duhet të japi argumenta të mëtjshme për justifikimin e tyre, të analizojë dhe të monitorojë situatën në terren dhe të planifikohen fonde nga shoqëria për rehabilitimin e tyre, e cila do të rriste mundësinë e uljes së tyre dhe në reduktimin e ujit pa të ardhura.
- Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturimi etj. të cilat mbeten pothuaj në të njëjtin nivel sa në vitin 2023 të ujit të prodhuar, shoqëria duhet të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika, tek matësat apo tek nën faturimi, duke kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësve etj.
- Të rritet dhe forcohet efektiviteti i kontrolleve dhe monitorimit në terren nga Task Force e cila vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes dhe me mbështetjen e njësive të qeverisjes vendore, të verifikojë në terren për lidhjet e paligjshme, anash kalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si dhe të kontrollojë punën e lexuesve të matësve dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e nën faturuar.
- Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej. Të saktësohen numri i popullsisë së shërbimit dhe i zonës së juridiksionit, sepse vihet re që nuk korrespondojnë me ato të publikuara nga INSTAT dhe kjo sjell një të analizë joreale të situatës lidhur me përdorimin e ujit.
- Të trajnojnë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.
- Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së, çdo fillim viti.

17. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Tiranë

Shoqëria UK Tiranë ka nën juridiksion 864,323 banorë. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet për 910,970 banorë ose 105,4 % të popullsisë totale. Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh.A UK Tiranë jepen në tabelën 46.

Nga të dhënat e Tabelës 46, referuar raportimeve të shoqërive pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 77.0 l/ditë për banorë, apo sipas faturimit aforfe që rezulton një konsum prej 108.4 l/ditë për banor, është larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor.

Këto vlera tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben dhe në juridiksion, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor, ose të shpjegojë arsyet e këtij nën faturimi.

Tabela 46. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.a UK Tiranë	Popullsia me shërbim	konsumi total ne m3	Konsumi I matur ne m3	Konsumi I pamatur ne m3	Nr. lidhjeve me mates	Nr.lidhjeve pa mates	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/dite, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2024	910,970	26,636,000	23,098,000	3,538,000	215,477	23,455	77.0	108.4	80.1

Referuar tendencës në rritje të vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve demografike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën 47, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre. Edhe për 2024 kemi mbajtur të njëjtën parametër të kapaciteteve të burimeve për ujë të pijshëm, pasi nuk ka një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela 47. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.a UK Tiranë	Popullsia e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2024	910,970	101,444,196	80.1	864,323	104,082,700	+ 329.9	+ 249.8

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga tabela 47, shihet se shoqëria UK Tiranë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë UK Tiranë

Për vitin 2024, shoqëria UK Tirane ka raportuar prodhimin total ne sasinë **101,444,196 m³ ujë**, i cili rezulton i matur në nivelin 69.5 % ndërsa pjesa tjetër vlerësohet.

Numri i lidhjeve totale për shërbimin e furnizimit me ujë rezulton 279,302 lidhje, nga të cilat 255,410 lidhje ose 91.5 % janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA) e për pasojë shoqëria e ka me të vështirë monitorimin e humbjeve të ujit në zonën e shërbimit si dhe ndërtimin e strategjive për zvogëlimin e tyre, me orientim prioriteti në DMA-të me problematike.

“Uji Pa të Ardhura” (UPA) në nivelin 61.82 % konsiderohet mjaftë i lartë dhe i pa pranueshëm. Administrimi i rrjeteve ka vështirësitë e veta pasi kjo shoqëri ka shtrirje të madhe territoriale ku ndërtimet gjatë 30 viteve janë bërë pa kriter e për pasojë rrjetet e furnizimit janë abuzuar nga banorët. Shoqëria vlerëson se niveli i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në sistemin e furnizimit është rreth 8 % të prodhimit vjetor. Nevoja për eliminim e tyre është imediate.

Monitorimi në 10 vite i humbjeve nëpërmjet Bilancit të Ujit ka treguar se vlerësimi i komponentëve përbërës të tij shpesh nuk janë përlllogaritur saktë, nevoja për trajnim të stafit teknik është evidente dhe e domosdoshme.

Në tabelën 48, paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për shoqërinë UK Tiranë, e cila krahasuar më vitin 2023, vërehet një trend i shumë lehte negativ (përkeqësues) , ndaj kërkohet angazhim serioz për uljen e nivelit të UPA-së.

Tabela 48. Bilancit i Ujit për Shoqërinë UK Tiranë Viti 2024.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	101,444,196	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	35,145,584	34.65%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	3,585,593	3.53%
Faturimi total	38,731,177	38.18%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	17,029	0.02%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	2,990,044	2.95%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	4,701,282	4.63%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	19,373,670	19.10%
Humbjet e dukshme (administrative)	27,064,996	26.68%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	3,241,344	3.20%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	1,943,566	1.92%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	1,684,768	1.66%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	16,960,570	16.72%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	11,800,741	11.63%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	35,630,989	35.12%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	62,695,985	61.80%
UJI PA TË ARDHURA	62,713,014	61.82%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 48:

- UPA në nivelin 61.82 % të prodhimit vjetor konsiderohet në nivele të performancës së dobët e cila duhet të përmirësohet.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i Prodhuar” në vlerën prej 69.5 %, çënon vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht nivelin e besueshmërisë së treguesit UPA, pasi mungesa e matësave të ujit ndikon si në faturim ashtu dhe në cilësinë e shërbimit për konsumatorët, mungesë motivimi për kursim uji, apo konsum të panevojshëm.
- Vlerësimi jo korrekt i komponentëve përbërës të bilancit të ujit vë në dyshim vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht treguesit UPA.
- Faturimi total 38.18 % matet në nivelin 90.74 % ndërsa 91.5% e konsumatorëve janë të pajisur me aparate ujëmatës.
- Konstatohet se humbjet administrative 26.68 % shkaktohen nga lidhjet e paligjshme në transmetim 2.95 % dhe shpërndarje 4.63 % si dhe nga pasaktësia në matjen e ujit, nën faturim 19.10 % e cila është vlerë shume e lartë dhe e papranueshme.

- Humbjet reale 35.12 % rezultojnë në nivele mjaft të larta që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes 16.72 % dhe të transmetimit 3.2% por dhe nga riparimet në linjat e ujësjellësit që janë në nivelin 11.63 %. Të dy këto komponentë duhet të verifikohen në terren dhe të saktësohen të dhënat mbi nivelin real që ato kanë.

Rekomandime:

- *Të shihet mundësia e përshpejtimit të investimeve të parashikuara për ndërtimin e 58 unazave (DMA) në rrjetin shpërndarës në zonën e shërbimit në kryeqytet, të cilat do të mundësojnë një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojnë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.*
- *Duke patur parasysh që jo të gjitha burimet e furnizimit me ujë janë të pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria i ka mundësitë financiare dhe duhet urgjentisht të marrë masa për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Shoqëria duhet të ketë një nga prioritetet kryesore të saj instalimin e matësve individuale për 100% të konsumatorëve të saj për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme.*
- *Hartimi i një plan veprimi me prioritet instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Hartimi i një plan veprimi instalimin e matësve inteligjente në të gjithë bizneset private që në mjaft raste nën faturohen nga lexuesit e matësve aktuale mekanike.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHË-së duke filluar nga zonat që ajo konsideron më problematike.*

- *Task- Forca të realizojë verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësive dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikës me ujin e nën faturuar.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej për çdo njësi administrative që ajo ushtron shërbimin e furnizimit me ujë.*
- *Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banoreve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo fillim viti për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë. Të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.*

18. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Vorë

Shoqëria UK Vorë raporton se ka nën juridiksion **41,397** banorë, ndërsa mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë ofrohet për **28,870 ose 69.73 %** e tyre. Prodhimi vjetor raportohet në sasinë **4,293,000 m³** ujë, dhe për këtë vit raportohet se gjithë sasia e ujit së prodhuar vlerësohet.

Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje për zonën e shërbimit të Sha UK Vorë, jepen në tabelën 49.

Nga të dhënat e Tabelës 49, konstatohen se vlera me faturimin me matësia dhe aforfe është shumë e ulët (42.6 dhe 68.4 l/ditë për banorë). Këto vlera tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben dhe në juridiksion, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor, ose të shpjegojë arsyet e këtij nën faturimi.

Tabela 49. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.UK Vore	Popullsia me sherbim	Konsumi total ne m3	Konsumi I matur ne m3	Konsumi I pamatur ne m3	Nr. lidhjeve me mates	Nr.lidhjeve pa mates	Konsumi i matur	Konsumi I pamatur	Konsumi Total
							I/dite, banor	I/ditë, banor	I/ditë, banor
Viti 2024	28,870	514,000	341,000	173,000	3,939	1,245	42.6	68.4	48.8

Nga ana tjetër referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 50, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe kapaciteti i burimet ujore që shfrytëzon kjo shoqëri.

Tabela 50. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh. UK Vorë	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futet ne sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar ne Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca ne Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(I/ditë, banor)		(në m3/vit)	(I/dite, banor)	(I/dite, banor)
Viti 2024	28,870	4,293,000	48.8	41,397	9,417,600	623	574

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga Tabela 50, shihet qartë se shoqëria UK Vorë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë, për popullsinë totale të regjistruar në zonën e saj të shërbimit sipas të dhënave të raportuara nga vet shoqëria. Në fokusin e shoqërisë duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në kërkesën për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit (81.78%) *niveli më i lartë në sektor*, për të arritur dhe qëllimin final “shërbim me cilësi të lartë” dhe “kohëzgjatje të furnizimit më ujë me 24/7” për çdo njësi furnizimi.

UPA për Ish Shoqërinë UK Vorë

Faturimi Total në nivel të patolerueshëm (**16.79% nga 19.01% në vitin 2023**) sidomos dhe tendenca përkeqësuese e këtij treguesi duke sjell rrjedhimisht dhe nivelin **“Uji Pa të Ardhura”, në nivelin 83.21 % nga 80.70% e prodhimit në vitin 2023**, nivele këto të pa tolerueshme. Shoqëria UK Vorë ka në administrim 5,774 lidhje me ujin, prej së cilave 4,529 lidhje faturohen me matje dhe pjesa e tjetër aforfe.

Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA) e për pasojë shoqëria e ka të vështirë monitorimin e humbjeve të ujit në zonën e shërbimit si dhe ndërtimin e strategjive për zvogëlimin e tyre, me orientim prioriteti në DMA-të më problematike.

Në Tabelën 51 paraqitën komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Vorë mbi të cilat bazohet analiza e humbjeve të ujit.

Tabela 51. Bilanci i Ujit për Shoqërinë UK Vorë – Viti 2024

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	4,293,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	548,000	12.76%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	173,000	4.03%
Faturimi total	721,000	16.79%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	61,239	1.43%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	455,089	10.60%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	601,061	14.00%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	772,792	18.00%
Humbjet e dukshme (administrative)	1,828,942	42.60%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	369,223	8.60%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	257,597	6.00%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	156,275	3.64%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	847,201	19.73%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	51,519	1.20%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,681,815	39.18%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	3,510,757	81.78%
UJI PA TË ARDHURA	3,571,996	83.21%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 51:

- UPA në nivelin 83.21 % të prodhimit vjetor, konsiderohet performanca më e keqe në rang sektori. Gjithsesi, vërtetësia e nivelit të UPA duhet verifikuar në terren duke u nisur nga të dhënat mbi prodhimin, lidhjet e ligjshme dhe të paligjshme, gjendja teknike e rrjetit etj.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA).
- Pasaktësia e mundshme në llogaritjen e sasisë së ujit të prodhuar (100 % me vlerësim), vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit, mungesa e DMA-ve etj, vë në dyshim vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht nivel të pabesueshëm të treguesit UPA.
- Humbjet teknike në nivelin 39.18% të prodhimit vjetor konsiderohen mjaft të larta e nivele të pa pranueshme përveç dhe faktit që janë rritur krahasuar me vitin 2023, ku 19.7 % e

prodhimit vjetor humbet në rrjetin shpërndarës dhe 8.80 % në linjën e transmetimit. Gjithashtu e papranueshme rezulton niveli i humbjeve nga rrjedhjet në burime apo stacione pompimi 9.64 % pasi rezultojnë në nivele të lartë dhe me tendencë rritjeje nga viti 2023.

- Humbjet administrative 42.60% e prodhimit konsiderohen të pa tolerueshme, ato shkaktohen nga lidhjet e paligjshme në transmetim 10.6% dhe shpërndarje 14.0 % si dhe gjatë gabimeve në vlerësimin e ujit të prodhuar, nën faturimet etj 18.0 % duke venë në rrezik gjendjen financiare dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë.
- Konsumi total faturohet me matje në nivelin 76 % ndërsa 78.4 % e konsumatorëve janë të pajisur me matësa individuale, duke përfaqësuar një nivel jo shumë të kënaqshëm të matjes. Synimi për nivel të matjes 100% të konsumit është domosdoshmëri për reduktimin e humbjeve administrative.

Rekomandime:

- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktoje një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.*
- *Duke patur parasysh që shoqëria raporton se vetëm uji që blihet me shumicë është i matur, dhe gjithësi sasia e ujit që prodhohet vetëm vlerësohet, nevoja për investime në ujëmatësa në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa me real.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, duke qënë se sipas raportimeve vetëm klientë familjarë rezultojnë pa ujëmatësa, dhe kjo do të mundësojë një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme të cilat rezultojnë në nivele të larta. Për këtë hartimi i një plan veprimi me prioritet instalimin e matësave në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale është imediate.*

- Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHE-së duke filluar nga DMA-të më problematike të UK Vorë.
- Task- Force e cila vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anash kalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësive dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikës me ujin e nën faturuar.
- Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej. Të planifikojë investime në ujëmatës për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, për të patur konsum të matur për çdo lidhje uji që faturohet.
- Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banoreve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992. Të saktësohen numri i popullsisë së shërbimit dhe i zonës së juridiksionit, sepse vihet re që nuk korrespondojnë me ato të publikuara nga INSTAT dhe kjo sjell një të analizë joreale të situatës lidhur me përdorimin e ujit.
- Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së, çdo fillim viti.

19. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Kamëz

Shërbimi i furnizimit me ujë në Bashkinë Kamëz ofrohet për 74.14 % të popullsisë në juridiksion. **Prodhimi vjetor raportohet 11,004,000 m³ ujë** prej cilës vetëm 98.2 % rezulton i matur, pjesa tjetër vlerësohet. Numri i lidhjeve me ujin është 30,026 lidhje, ku 85.29 % e tyre janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe.

Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh.A UK Kamëz jepen në tabelën 52.

Nga të dhënat e Tabelës 52, referuar raportimeve të shoqërive pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur

në litra/ditë për banor prej 87.2 l/ditë për banorë, apo sipas faturimit aforfe që rezulton një konsum prej 59 l/ditë për banor, është larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor.

Këto vlera tregojnë se shoqëria duhet të fokusohet në verifikimin e numrit të banorëve që u shërben dhe në juridiksion, duke u fokusuar tek konsumatorët me dhe pa matës (nëse përfshijnë në to dhe klientët jo aktivë), sepse për faturimin aforfe, referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë norma prej 150 litra/ditë për banor, ose të shpjegojë arsyet e këtij nën faturimi.

Tabela 52. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Shoqëria UK Kamëz	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m3	Konsumi i matur në m3	Konsumi i pamatur në m3	Nr. lidhjev e me matës	Nr. Lidhjev e pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsum i Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2024	111,292	3,367,000	3,000,000	367,000	23,657	4,165	87.2	59.0	82.9

Referuar tendencës në rritje të vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve demografike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën 53, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre. Edhe për 2024 kemi mbajtur të njëjtën parametër të kapaciteteve të burimeve për ujë të pijshëm, pasi nuk ka një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela 53. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Shoqëria UK Kamëz	Popullsia e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futet ne sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar ne Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca ne Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m3/vit)	(l/dite, banor)	(l/dite, banor)
Viti 2024	111,292	11,004,000	82.9	150,101	13,824,000	+ 252	+ 169

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së.

Nga tabela 53, shihet se shoqëria UK Kamëz ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë UK Kamëz

Për vitin 2024, shoqëria UK Kamëz raporton se “uji që hyn në sistem”, në sasinë 11,004,000 m³ ujë, nuk prodhohet tërësisht nga kjo shoqëri. Për çdo vit, Shoqëria UK Kamëz blen ujë nga UK Tiranë e cila për këtë vit është rreth 4.660.000 m³. Në ujin e prodhuar që rezulton 98.2 % i matur, 42.35 % të tij është sasia e ujit të blerë me shumicë që është i matur.

Numri i lidhjeve me ujin është 30,026 lidhje, ku 85.3 % e tyre janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe.

Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA) e për pasojë shoqëria e ka të vështirë monitorimin e humbjeve të ujit në zonën e shërbimit si dhe ndërtimin e strategjive për zvogëlimin e tyre, me orientim prioriteti në DMA-të me problematike.

Për vitin 2024 vihet re një rritje e lehte e parametrit “Faturimi Total” në 2024 në vlerë 32.9 % nga 28.55% i raportuar në 2023, ndaj sasisë së ujit të prodhuar, ndërsa “Uji Pa të Ardhura” (UPA) rezulton në nivelin 67.1 % nga 71,45 % në vitin 2023, duke vlerësuar të paparanueshëm faktin që humbjet vazhdojnë të jenë në nivele mjaft të lartë.

Rrjetet e furnizimit kanë shtrirje territoriale në zona të reja banimi (dikur toka bujqësore) ku ndërtimet gjatë 30 viteve janë bërë pa kriter e për pasojë rrjetet e furnizimit janë abuzuar nga banorët duke lidhur në to lidhje dyfishe apo të paligjshme. Shoqëria vlerëson humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjet të transmetimit në nivelin 19.08 % ndërsa nga lidhjet e paligjshme në rrjet të shpërndarjes 40.03 % nivele këto të papranueshme dhe një përkeqësim nga viti 2023 ku këto humbje ishin 34.72 % dhe për vitin 2024 raportohen 59.11 %. Nevoja për eliminim e tyre është emergjente pasi vë në vështirësi financiare shoqërinë UK Kamëz.

Shpesh herë janë konstatuar pasaktësi dhe raportim jo korrekt mbi komponentët përbërës të bilancit të ujit, nevoja për trajnim të stafit teknik është evidente.

Në Tabelën 54, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për shoqërinë UK Kamëz mbi bazën e të cilave është kryer Bilanci dhe analiza e humbjeve të ujit.

Tabela 54. Bilanci i Ujit për Shoqërinë UK Kamëz – Viti 2024

Emërtimi	Viti 2024 (m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	11,004,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	3,190,000	28.99%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	430,000	3.91%
Faturimi total	3,620,000	32.90%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	137,500	1.25%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	2,100,000	19.08%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	4,404,500	40.03%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	300,000	2.73%
Humbjet e dukshme (administrative)	6,804,500	61.84%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	250,000	2.27%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	12,000	0.11%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	20,000	0.18%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	100,000	0.91%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	60,000	0.55%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	442,000	4.02%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	7,246,500	65.85%
UJI PA TË ARDHURA	7,384,000	67.10%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 54:

- UPA për vitin 2024 është 67.1 % me një përmirësim prej 4.35 % nga viti 2023 por sërish rezulton në nivele të pakënaqshme dhe të pa tolerueshme.
- Humbjet administrative në nivelin 61.84% të prodhimit shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetet e transmetimit 19.08 % në shpërndarje 40.03 % dhe nga pasaktësi në matjen e ujit e nën faturim 2.73%. Këto humbje konsiderohen mjaft të larta dhe të papranueshme pasi kanë një impakt financiar negativ dhe rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë. Shihet që nga viti 2023 humbjet administrative janë raportuar me një rritje shumë të lartë dhe shoqëria justifikon këtë raportim si saktësim të të dhënave për vitin 2024 duke vënë në pikëpyetje raportimin jo të saktë për vitin 2023.
- Humbjet teknike në nivelin 4.02 %, rezultojnë kryesisht nga rrjedhjet në linjën e transmetimit 2.27 % të cilat konsiderohen në kufijtë të pranueshme por duke parë raportimin për vitin 2023 ku këto humbje ishin në nivelin 20.92 % këto të dhëna mbeten të pabesueshme. Shoqëria duhet të analizoje situatën në terren për verifikimin dhe saktësimin e të dhënave që raportohen.

Rekomandime:

- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojnë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme.*
- *Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banoreve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*
- *Hartimi i një plan veprimi me prioritet instalimin e matësave në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale, por edhe për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, për të patur konsum të matur për çdo lidhje uji që faturohet.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme në linjat e transmetimit, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHË-së duke filluar nga DMA-të më problematike të UK Kamëz.*
- *Të ngrihet një Task- Force e cila vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anash kalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësave dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikës me ujin e nën faturuar.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej.*

- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo fillim viti për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë. Të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.*

ANEKSI 1. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Nr	Shoqëritë	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Popullsia me shërbim	Uji I Prodhuar që futet në sistem (m³)	Konsumi total ne m³	Konsumi I matur ne m³	Konsumi I pamatur ne m³	Nr. lidhjeve me matës	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
										I/dite, banor	I/ditë, banor	I/ditë, banor
1	Sh.R.UK Berat	228,654	159,062	6,899,000	3,735,300	3,577,000	158,300	35,991	3,187	67.1	33.5	64.3
2	Sh.R.UK Elbasan	401,282	256,257	21,034,000	6,832,000	6,065,000	767,000	56,568	6,313	72.1	81.7	73.0
3	Sh.R UK Dibër	170,573	92,475	6,403,000	3,972,000	2,383,000	1,589,000	14,384	7,779	108.8	134.1	117.7
4	Sh.R.UK Durrës	577,663	491,284	52,012,120	10,845,400	9,434,579	1,410,821	118,185	7,365	55.9	134.1	60.5
5	Sh.R.UK Fier	323,508	200,172	15,970,320	5,277,920	3,830,790	1,447,130	40,253	9,790	65.2	101.2	72.2
6	Sh.R. UK Gjirokastrë	145,355	114,204	6,382,000	3,592,770	2,053,640	1,539,130	19,580	8,946	71.8	117.7	86.2
7	Sh.R. UK Korçë	226,121	223,859	7,690,730	4,507,400	4,430,000	77,400	49,293	1,903	56.5	23.4	55.2
8	Sh.R.UK Kukës	89,467	48,968	3,540,456	1,546,000	843,401	791,819	6,289	5,060	85.2	99.4	86.5
9	Sh.R.UK Lezhe	211,947	116,968	8,062,000	2,769,000	2,039,000	730,000	24,741	4,458	56.4	111.8	64.9
10	Sh.R.UK Lushnjë	188,296	106,532	6,455,420	2,609,000	2,600,000	9,000	26,665	30	66.9	206.0	67.1
11	Sh.R. UK Pogradec	116,853	104,036	3,644,260	2,148,000	2,098,000	50,000	24,473	931	57.4	35.9	56.6
12	Sh.R. UK Sarandë	125,529	100,080	7,125,060	2,277,990	2,174,590	103,400	25,959	1,529	63.0	50.9	62.4
13	Sh.R. UK Shkodër	334,968	178,450	14,213,090	4,268,000	2,579,000	1,689,000	31,526	10,255	52.5	105.6	65.5
14	Sh.R.UK Vlorë	250,294	216,567	26,643,400	5,477,000	3,113,000	2,364,000	47,454	17,952	54.3	109.0	69.3
15	UK Tiranë	864,323	910,970	101,444,196	26,636,000	23,098,000	3,538,000	215,477	23,455	77.0	108.4	80.1
16	UK Vorë	41,397	28,870	4,293,000	514,000	341,000	173,000	3,939	1,245	42.6	68.4	48.8
17	UK Kamëz	150,101	111,292	11,004,000	3,367,000	3,000,000	367,000	23,657	4,165	87.2	59.0	82.9
	TOTAL	4,446,331	3,460,045	302,816,052	90,374,780	73,660,000	16,804,000	764,434	114,363	68.9	87.0	71.6

ANEKSI 2. Tabela Përmbledhëse e Bilancit të Ujit për çdo Shoqëri

Nr	Shoqëritë UK	Volumi vjetor i ujit të prodhuar që futet në sistem (m³)		Faturimi Total	Konsumi i Autorizuar i pafaturuar	Humbjet administrative	Humbjet teknike	Humbjet Totale	Uji pa të ardhura (UPA)	Uji pa të ardhura (UPA)
		I matur	I vlerësuar	(m³)	(m³)	(m³)	(m³)	(m³)	(m³)	%
1	Sh.R.UK Berat-	1,489,974	5,409,026	4,299,822	544,835	760,543	1,293,800	2,054,343	2,599,178	37.67
2	Sh.R.UK Dibër	0	6,403,000	4,664,000	107,991	1,091,490	539,519	1,631,009	1,739,000	27.16
3	Sh.R.UK Durrës	38,650,866	13,361,254	16,996,858	0	15,669,818	19,345,454	35,015,272	35,015,272	67.32
4	Sh.R.UK Elbasan	18,381,000	2,653,000	7,898,000	1,169,104	6,305,280	5,661,616	11,966,896	13,136,000	62.45
5	Sh.R.UK Fier	15,970,320	0	6,153,860	309,460	6,930,000	2,577,000	9,507,000	9,816,460	61.47
6	Sh.R.UK Gjirokastrë	3,265,297	3,116,703	4,112,000	72,000	234,000	1,964,119	2,198,119	2,270,119	35.57
7	Sh.R.UK Korçë	6,152,584	1,538,146	5,112,270	0	851,885	1,726,553	2,578,438	2,578,438	33.53
8	Sh.R.UK Kukës	0	3,540,456	2,001,549	68,468	700,439	770,000	1,470,439	1,538,907	43.47
9	Sh.R.UK Lezhe	3,121,600	4,940,400	3,335,200	6,689	3,306	4,716,805	4,720,111	4,726,800	58.63
10	Sh.R.UK Lushnje	6,455,420	0	2,961,343	52,396	1,449,616	1,992,048	3,441,664	3,494,060	54.13
11	Sh.R.UK Pogradec	2,879,169	765,091	2,391,927	33,470	180,707	1,038,146	1,218,853	1,252,323	34.36
12	Sh.R.UK Sarandë	5,599,600	1,525,460	3,021,630	71,307	1,040,359	2,991,764	4,032,123	4,103,430	57.59
13	Sh.R.UK Shkodër	10,233,425	3,979,665	5,116,211	69,828	8,077,021	950,021	9,027,042	9,096,870	64.00
14	Sh.R.UK Vlorë	0	26,643,400	7,047,000	57,000	11,460,695	8,078,605	19,539,300	19,596,300	73.55
15	UK Tirane	70,475,606	30,968,590	38,731,177	17,029	27,064,996	35,630,989	62,695,985	62,713,014	61.82
16	UK Vore	2,677,000	1,616,000	721,000	61,239	1,828,942	1,681,815	3,510,757	3,571,996	83.21
17	UK Kamëz	11,004,000	0	3,620,000	137,500	6,804,500	442,000	7,246,500	7,384,000	67.10
Totali		196,355,861	106,460,191	118,183,847	2,778,316	90,453,596	91,400,254	181,853,850	184,632,166	61.00